

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7661 E martë 25 Shtator 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Ligjvënësit amerikanë po debatojnë si të reagojnë ndaj akuzave të ngritura kundër personit të emëruar nga Presidenti Trump për anëtar i Gjykatës së Lartë ...
Vijon në faqen 20

Nga "ZËRI I AMERIKËS"

Përse luan politika në emërimet për Gjykatën e Lartë?



Opinion i Ditës

Një nga argumentet e forta të atyre që predikojnë zgjidhjen e ndryshimit të kufijve është edhe "fati" i popullsisë që banojnë në mizëri, në margjina të dy ...
Vijon në faqen 21

Nga ANDI BUSHATI

Ndarja e Kosovës, nënshtrimi para një ideje raciste



Policia shpërndan foton e Enver Bajrit
Anëtarët e grupit "Bajri" në qeli, ja kush është 'truri' që fshihet në Belgjikë

Xhafaj: Grupi kishte influencë shtetërore, edhe në polici. Avokati: Po shkelet ligji

Të arrestuarit e fisit Bajri kanë dalë ditën e djeshme përpara Gjykatës së Krimeve të Rënda për t'u njohur me masën e sigurisë. Krimet e Rënda kanë lënë në burg Safet Bajrin dhe 5 anëtarë të tjerë të grupit kriminal "Bajri". Konkretisht dje u dha vendimi për Ilir Rustemi (Bajri), i arrestuar në 6 shtator në Shkodër ...
Në faqen 2-3

TIRANE/ GATI PROJEKTI, 340 FAMILJE DO TE MARRIN NDIHME EKONOMIKE KOMPENSIM ENERGJIE PER FAMILJET NE NEVOJE

Zbardhet projektvendimi që do miratohet në Këshillin Bashkiak, përfitojnë pensionistët dhe personat me aftësi të kufizuar. Përfitimet për çdo kategori



(Në foto) Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliq, duke folur gjatë një mbledhjeje të Këshillit Bashkiak të Tiranës

Në faqen 10-11

NISMA E RE

PD-ja prezanton ligjin "Antimafia", Lulzim Basha: Do të çlirojmë ekonominë

Në faqen 4-5

REAGIMI I AMBASADES

"Shullazi", SHBA: Prokurorët të qëndrojnë kundër njerëzve të krimit

Në faqen 2

SHFAQJA NGA KOSOVA

Çelet Festivali Mbarëkombëtar i Teatrit, "Kaligula" ngre sallën në këmbë

Në faqen 19

INTERVISTA

Arian Çani: Porosia ime për djalin, jeta është me ngjyra, jo bardhezi

Suplement

VIZITA E PRESIDENTIT



Meta në samitin e Paqes në SHBA: Shqipëria mbështet ndaljen e konflikteve

Në faqen 7

EMRAT/ Agjencia e Trajtimit të Pronës publikon listën e përfituesve

Pronarët, kompensimi për dosjet 1993-2013

Tri afatet për pagesat e përshpejtuara, 30 ditë afat për ankimimin

NGA ORNELA MANJANI

Publikohet lista e emrave të pronarëve për vendimet e viteve 1993-2013, të cilat janë për kompensim financiar. "Gazeta Shqiptare" boton emrat e pronarëve që do të futen zyrtarisht për kompensim financiar ose fizik në regjistrin



e Agjencisë së Trajtimit të Pronave. Lista së bashku me vlerësimin financiar për 140 dosje është publikuar në Fletoren Zyrtare, pas aprovimit që është bërë nga komisioni i shqyrtimit të dosjeve në Agjencinë e Trajtimit të Pronave. Me zbardhjen ...
Në faqen 8

BANDA "BAJRI" MASAT

Avokatët, letër Arta Marku: Akuza të jetë e pandikuar në vendimmarrje

"Shullazi", ambasada e SHBA: Prokurorët të qëndrojnë kundër kriminelëve

"Populli shqiptar meriton drejtësi"

Në përgjigje të intereseve të "Zërit të Amerikës" për situatën e krijuar në Prokurorinë e Krimeve të Rënda për çështjen Shullazi, reagoi ditën e djeshme ambasada amerikane në Shqipëri. Një ditë përpara seancës për dhënien e pretendencës në procesin ndaj Emiljano Shullazit dhe bashkëpunëtorëve të tij, ambasada thekson se "populli shqiptar meriton një sistem drejtësie ku policia dhe prokurorët qëndrojnë së bashku kundër kriminelëve". Në reagimin e saj ambasada shtoi se "mbështesim prokurorët e guximshëm që kërkojnë drejtësi, edhe kur ka rreziqe". Nga ana tjetër ditën e djeshme mbrojtësit ligjor të Emiljano Shullazit, Gilmando Danit dhe Endri Qyqjas i janë drejtuar me një letër drejtueses së Prokurorisë për Krimet e Rënda, Donika Prela dhe Prokurorës së Përgjithshme, Arta Marku në lidhje me ecurinë e procesit. Në Letrën e firmosur nga avokatët Ravik Gurra, Vladimir Meci dhe Denion Bogdani, e cilësojnë procesin si një ndër çështjet që ka tërhequr më shumë vëmendjen e opinionit publik. Në letër avokatët tërheqin vëmendjen e znj. Prela për të garantuar se prokurorët e çështjes do të jenë të pandikuar në vendimmarrje. "Jo gjithmonë e vërteta lidhur me këtë çështje është bërë e njohur dhe kjo ka krijuar në opinion idenë se po ndëshkohet një grup i rrezikshëm kriminal, ndërsa prokurorët e çështjes kanë marrë pamjen e kalorësve në këtë betejë kundër kriminit. Kjo situatë ka dëmtuar shqyrtimin e "fiohtë" dhe "të paanshëm" të kësaj çështjeje, ka dhunuar parimin madhor të prezumimit të pafajësisë dhe tashmë që çështja ka mbërritur në finish, rrezikon që paragjykimin dhe zhurma e krijuar rreth saj, të mos lejojë si përfaqësuesit e akuzës, ashtu dhe vetë gjykatën që të vendosin sipas "liberum arbitrium", pra, sipas zgjedhjes



Emiljano Shullazi

së tyre të lirë, sipas bindjes së bazuar mbi prova dhe vetëm mbi to", thuhet në letrën e avokatëve. Emrat e katër prokurorëve që do të përfaqësojnë në gjykim çështjen në ngarkim të të pandehurve Emiljano Shullazi, Gilmando Dani, Endrit Qyqja, Endrit Zela dhe Blerim Shullazi do të bëhen publikë zyrtarisht në seancën gjyqësore të ditës së sotme. Mësohet se Donika Prela, e cila është Drejtuese e Prokurorisë së Krimeve të Rënda do të jetë drejtuese e grupit të prokurorëve në çështjen "Shullazi". Po kështu pjesë e grupit të prokurorëve do të jetë edhe Gentian Osmani.

DOËJA SHULLAZI

Pak ditë më parë prokurorët e Krimeve të Rënda kanë braktisur mbledhjen e thirrur nga drejtuesja e tyre, Donika Prela. Kjo pasi këta prokurorë refuzuan hedhjen e shortit në procedimin penal në gjykim në ngarkim të të pandehurve Emiljano Shullazi, Gilmando Dani, Endrit Qyqja, Endrit Zela dhe Blerim Shullazi, të cilët ndodhen pas hekurave për një sërë akuzash. Ky refuzim çoi në kërkesën për hetim disiplinor ndaj tyre nga ana e kryeprokurores Arta Marku. Konkretisht Prokurorja e Përgjithshme urdhëroi transferimin e përkoreshëm në rrethe të tre

nga dhjetë prokurorët që refuzuan hedhjen e shortit për dosjen Shullazi. Bëhet fjalë për prokurorët: Olsian Cela, i cili do të transferohet në Prokurorinë e Beratit, Sonila Muhametaj, e cila do të transferohet në Prokurorinë e Pukës dhe Besim Hajdarmatajn, i cili do të transferohet në Prokurorinë e Pogradecit. Gjithashtu, Arta Marku kërkoi që për këta

TIRANE- Zëvendëskryeministria Senida Mesi, ka folur ditën e djeshme nga foltorja e Kuvendit për luftën ndaj kriminit të organizuar.

Ajo u shpreh se operacioni "Forca e ligjit" është duke vepruar prej kohësh dhe ka dhënë rezultate konkrete ku disa grupe kriminale janë goditur. Mesi si deputete e qarkut të Shkodrës, ka prekur çështjet e sigurisë dhe rendit, veçanërisht pas ndalimit të grupit famëkeq "Bajri" nga ana e policisë. Zv/kryeministria Mesi u shpreh se "lufta ndaj kriminit të organizuar nuk lejon asnjë kompromis sado risk që mbart dhe ne jemi të vendosur të sigurojmë jetën dhe mirëqenien e çdo shqiptari, çdo investitori të

AMBASADA AMERIKANE

Një ditë përpara seancës për dhënien e pretendencës në procesin ndaj Emiljano Shullazit dhe bashkëpunëtorëve të tij, ambasada thekson se "populli shqiptar meriton një sistem drejtësie ku policia dhe prokurorët qëndrojnë së bashku kundër kriminelëve".



XHAFAJ: "BAJRI", INFLUENCE SHTETERORE


Grupi "Bajri" ka pasur influencë të rëndësishme politike, por edhe në policinë e Shkodrës. Deklarata u bë nga ministri i Brendshëm në studion e Sokol Ballës në Vizion Plus. "Ky grup ka pasur influencë shtetërore në kohëra të ndryshme ndër vite, madje edhe në polici. Në kohët e fundit ne kemi punuar shumë që t'ia heqim këtë influencë", tha ai.

prokurorë, por edhe për shtatë të tjerë të nisë edhe hetimit disiplinor për thyerje të urdhrat të drejtueses së Krimeve të Rënda Donika Prela, e cila dështoi në hedhjen e shortit për dosjen Shullazi. Bëhet fjalë për prokurorët Përparim Kulluri, Behar Dibra, Arenc Çela, Edvin Kondili, Pranvera Pustina, Eugen Beçi dhe Blerim Tominaj. "Prokurori i Përgjith-

hëm znj. Arta Marku duke marrë shkas nga ngjarja e fundit e datës 19 shtator 2018 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, mbi refuzimin nga ana e prokurorëve për hedhjen e shortit në procedimin penal në gjykim në ngarkim të të pandehurve Emiljano Shullazi, Gilmando Dani, Endrit Qyqja, Endrit Zela dhe Bler-

im Shullazi, për kryerjen e veprave penale parashikuar nga nenet 109/b; 333/a; 334 etj. të Kodit Penal urdhëroi fillimin e hetimit disiplinor ndaj prokurorëve: Olsian Cela; Përparim Kulluri; Behar Dibra; Sonila Muhametaj; Arenc Çela; Edvin Kondili; Pranvera Pustina; Eugen Beçi; Blerim Tominaj dhe Besim Hajdarmataj", thuhet në njoftimin e prokurorisë.

Banda e Bajreve, Senida Mesi: Asnjë kompromis me krimin



Zëvendëskryeministria Senida Mesi

huaj apo vendas". Në fjalën e saj, teksa foli për investimet në ekonomi, zëvendëskryeministria u ndal edhe tek reforma në drejtësi dhe vetingu, si parakusht për zhvillimin ekonomik.

"Reforma në drejtësi do të vazhdojë të thellohet, vetingu po jep rezultatet dhe ngritja e organeve të reja do të mundësojë më në fund drejtësinë e re që është parakusht për çdo hap që hedhim drejt zhvillim-

it ekonomik dhe demokratizimit të vendit", -u shpreh zëvendëskryeministria. Ndërkohë, lidhur me investimet në bujqësi, Mesi bëri të ditur se "janë marrë të gjitha masat e nevojshme nga ana e qeverisë shqiptare për hapjen e programit të financimit "IPARD II". 71 milionë euro grante për sektorin e zhvillimit rural të Shqipërisë do të financohen nga BE dhe 23 milionë euro do të jetë vlera e financimit nga ana qeverisë shqiptare, në mbështetje të fermerëve dhe agrobizneseve shqiptare".



Enver Bajri, i njohur si truri i bandës 'Bajri', që e kishte shtrirë aktivitetin e saj kriminal në disa shtete konsiderohet si një ndër njerëzit më të kërkuar të momentit. Policia publikon foton e 45-vjeçarit, i cili dyshohet si truri i bandës më të rrezikshme që ka vepruar ndër vite në veri të vendit. 45-vjeçari, mundi t'i shpëtonte superaksionit të koduar "Oaz". Gjatë të cilit u vunë në pranga 11 të dyshuar si anëtarë të grupit kriminal, mes tyre dhe krahu i tij i djathtë, Safet Rustemi Bajri. Ai dyshohet se ndodhet jashtë vendit dhe konkretisht në Belgjikë. Emri i 45-vjeçarit gjendet tashmë në listën e personave të shumëkërkuar, për faktin se gjykata për Krime të Rënda caktoi ndaj tij masën e "arrestit me burg" në mungesë, ndërsa fotoja u është shpërndarë pikave të kalimit kufitar dhe policive

Policia e Shtetit: Dyshime se fshihet në Belgjikë Publikohet fotoja e "trurit" të bandës, Enver Bajri në listën e personave të shumëkërkuar



Enver Bajri

45-vjeçari Enver Bajri mundi t'i shpëtonte superaksionit të koduar "Oaz". Ai dyshohet se ndodhet jashtë vendit dhe konkretisht në Belgjikë. Emri i 45-vjeçarit gjendet tashmë në listën e personave të shumëkërkuar, për faktin se gjykata për Krime të Rënda caktoi ndaj tij masën e "arrestit me burg" në mungesë, ndërsa fotoja u është shpërndarë pikave të kalimit kufitar dhe policive të vendeve partnere.

të vendeve partnere. Ndonëse vëllai i tij, Behar Bajri ndodhet në burg, si dhe djemtë e xhaxhait Sefet dhe Ilir Bajri, 45-vjeçari është ende në arrati. "Gazeta Shqiptare" ka arritur të sigurojë një foto të vjetër ku shihet Enver Bajri, i cili dyshohet se fshihet në Belgjikë. Po ashtu, referuar

burimeve zyrtare mësohet se 45-vjeçari merrej me trafik drogash të forta, që i merrte nga Amerika Latine dhe i transportonte drejt vendeve të Bashkimit Europian. Ka dyshime se ai përdorte si transit Shqipërinë. Kujtojmë se si pjesë e kësaj bande u arrestuan 11 persona, të cilët dyshohet se mer-

reshin me trafik droge, ndërsa vepronin në Tiranë, Shkodër, Holandë dhe Belgjikë. Konkretisht të shtunën, në Rotterdam u arrestuan nga policia holandeze Behar Brajoviq (Bajri) dhe Samet Halluni. Ndërsa nga operacioni i zhvilluar në Tiranë dhe Shkodër ranë në pranga Safet Rustemi Bajri, Ilir

Rustemi, Emrah Plaku, Astmer Bilali, Armir Grimaj, Fabiol Rexhepi, Ismet Idrizi, Denis Brajoviq dhe Klaudio Haxhalliu. Anëtarët e grupit Bajri dyshohen për disa vrasje dhe shpërthime me tritol të ndodhura përgjatë muajve të fundit në Shkodër, ndonëse zyrtarisht u janë listuar akuzat vetëm për dy vrasje të regjistruara në Shkodër përgjatë viteve 2001-2002. Akuzat për vrasje, rëndojnë ndaj Behar Brajrit, gjithashtu, i dyshuar se luante rolin e drejtuesit të një prej fraksioneve të bandës. Ai dyshohet për vrasjen e Arben Tuzit në 2001 dhe vrasjen e 15-vjeçares, Fabiola Hyseni, bashkëjetuese e tij, krim i ndodhur qershorin e 2002. Behar Bajri është prangosur në Holandë, bashkë me Samet Hallunin, anëtar aktiv i grupit kriminal. Aksioni për goditjen e grupit Bajri është komentuar gjatë në mediat holandeze.

U arrestuan në kuadër të operacioni "Oaz", Safet Bajri njihet me dy masa sigurie

Të arrestuarit e fisit "Bajri", kanë dalë ditën e djeshme përpara Gjykatës së Krimeve të Rënda për t'u njohur me masën e sigurisë. Krimet e Rënda kanë lënë në burg në burg Safet Brajrin dhe 5 anëtarë të tjerë të grupit kriminal "Bajri". Konkretisht dje u dha vendimi për Ilir Rustemi (Bajri), i arrestuar në 6 shtator në Shkodër; Emrah Plaku, i arrestuar në 6 shtator në Shkodër; Astmer Bilalin, i arrestuar në 6 shtator në Shkodër; Armir Grimaj, arrestuar në Shkodër; Safet Rustemi (Bajri), i arrestuar në Tiranë dhe Fabiol Rexhepi, i arrestuar në Shkodër. Në përfundim të procesit gjyqësor ka reaguar avokati mbrojtës i Safet Brajrit, i cili e ka cilësuar të paligjshëm vendimin e Krimeve të Rënda duke theksuar se nga pala mbrojtëse u ofrua garancia pasurore, por kjo nuk u mor parasysh. Ndërkohë ditën e sotme pritet të dalin para Krimeve të Rënda Ismet Idrizi, i arrestuar në Shkodër; Denis Brajoviq, i arrestuar në Tiranë dhe Klaudio Hoxhalliu, i arrestuar në Tiranë.

SEANCA GJYQËSORE

Mëngjesin e së hënës i konsideruar nga mediat belge si një kriminel tejet i rrezikshëm, Safet Bajri doli përpara gjykatës së Shkodrës. Aty mësoi se sapa i janë hapur llogaritë me drejtësinë belge, ku rezultoi i dënuar me 9 vite burgim, për vepra të rënda kriminale. Prej andej, ai u transferua nën masa të rrepta sigurie në Gjykatën për Krime të Rënda. Seanca gjyqësore e parashikuar për të filluar në orën 14.00 u shty për afro 45 minuta, në pritje të personazhit të shumëpërfollur.

Në kafazin e xhamtë bash-

Vrasje, drogë, gjobëvënie e shantazh, lihen në burg anëtarët e grupit "Bajri"

Avokati Hoxha: Vendimi, i paligjshëm



I arrestuari Safet Rustemi (Bajri)

FSHF

Federata Shqiptare e Futbollit ka pezulluar trajnerin e Kombëtares së femrave, Armir Grima, i cili ishte mes personave të arrestuar pak ditë më parë në Shkodër. Armir Grima dyshohet për trukim ndeshjesh. FSHF bën të ditur se Grima do të jetë i pezulluar deri sa të vendoset drejtësia për të.

kë me të u ulën edhe të dyshuarit, Ilir Rustemi Bajri, Emrah Plaku, Astmer Bilali, Armir Grimaj e Fabiol Rexhepi, të dyshuar si anëtarë të grupit. Ai dështoi në përpjekjet për të rifituar lirinë me garanci pasurore. Për 6 nga 11 të arrestuarit, Gjykata e Krimeve të Rënda konfirmoi masën arrest me burg. Në përfundim të seancës gjyqësore Arbër Hoxha, avokati i Safet Brajrit e ka cilësuar të

paligjshëm vendimin e Krimeve të Rënda dhe tha se nga pala mbrojtëse u ofrua garancia pasurore, por kjo nuk u mor parasysh. Sipas tij akuzat e vetme ndaj klientit të tij është ndikimi në gara sportive. "Gjykata e Krimeve të Rënda në kundërshtim me nenin e la në fuqi arrestim me burg ndërkohë që duhet të kishte vendosur garanci pasurore. E ofruam në masën 1 mln lekë ose sa ta kërkonte

TE ARRESTUARIT

1. Behar Brajoviq, (Bajri) arrestuar në Rotterdam, Holandë;
2. Samet Halluni, i arrestuar në Rotterdam, Holandë;
3. Ilir Rustemi, i arrestuar në Shkodër;
4. Emrah Plaku, i arrestuar në Shkodër;
5. Astmer Bilali, i arrestuar në Shkodër;
6. Armir Grimaj, arrestuar në Shkodër;
7. Safet Rustemi (Bajri), i arrestuar në Tiranë;
8. Fabiol Rexhepi, i arrestuar në Shkodër;
9. Ismet Idrizi, i arrestuar në Shkodër;
10. Denis Brajoviq, i arrestuar në Tiranë;
11. Klaudio Hoxhalliu, i arrestuar në Tiranë.

NE KËRKIM;

1. Enver Bajri, 45 vjeç
2. N.H., 34 vjeç.

22

TË SHOQËRUAR

Policia ka ushtruar kontrollë në Laç dhe Lezhë, pasi dyshohet se në këto dy qytete fshihen anëtarë të bandës "Bajri". Mësohet se kanë kontrolluar rreth 50 automjete luksoze në Laç dhe Lezhë. Gjatë këtij operacioni janë shoqëruar për verifikim të paktën 22 persona.

gjykata. Aktualisht masa e sigurimit për Safet Rustemin përveç se ndikimit në gara sportive s'ka asgjë tjetër: Nuk mund të shprehim për akuzat në vende të tjera. Për të gishtat u la. Ndërsa për tre që kanë dalë në gjyq në Shkodër, janë arrestuar në flagrancë nuk kanë lidhje me këtë procedim", deklaroi avokati Hoxha. 11 persona u arrestuan në Tiranë, Shkodër e Rotterdam, në operacionin e policisë që u

finalizua pas një hetimi 6 mujor. Mes të arrestuarve ishin Safet Bajri dhe vëllai i tij Ilir Rustemi, të konsideruar si njerëzit kryesorë të grupit. Në kërkim janë shpallur edhe 2 persona të tjerë, Enver Bajri, i konsideruar si koka e këtij grupi dhe një tjetër person me iniciale N.H.

HETIMI

Veprimet hetimore, nën drejtimin e Prokurorisë së Krimeve të Rënda, deri në

goditjen e plotë të gjithë grupit kriminal "Bajri" kanë zgjatur mbi 6 muaj. Burime zyrtare thanë se hetimet u bazuan tek dhjetëra orë përgjime, mijëra informacione të shkëmbyera me partnerët, u analizuan mijëra faqe të dhëna, si edhe u kryen veprime pro-aktive në terren, përmes kontrollit nga ajri (dron) dhe vëzhgimit intensiv.

Oficerë të Policisë së Shtetit, në bashkëpunim me oficerë të kontaktit të vendeve të përfshira në operacion, kanë kryer veprime në terren për evidentimin, lokalizimin dhe ndalimin e shtetaseve anëtarë të grupit, që vepronin jashtë Shqipërisë, e kryesisht në Holandë. Akuzat ndaj anëtarëve të këtij grupi kriminal janë: "Vrasje me dashje e mbetur në tentativë", në bashkëpunim, "Vrasje me dashje", e kryer në bashkëpunim, "Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve dhe municioneve luftarake", "Organizim i lotarive të palejuara", "Pastrim i produkteve të veprës penale" të kryer në bashkëpunim, "Shtrengim me anë të kanosjes ose dhunës për dhënie të pasurisë", kryer në bashkëpunim, "Përkrahje e autorit të krimit", "Moskallëzimi krimi", "Prodhim e shitje e lëndëve narkotike". Si vepra të rënda kriminale, të dokumentuara deri tani janë 2 vrasje të ndodhura në Shkodër, ngjarje e ndodhur në 7 shkurt 2001, ku u vra shtetasia A.T., dhe ngjarje e datës 20 qershor 2002, ku u vra shtetasia F.H., 15 vjeçe. Gjatë veprimeve hetimore ka rezultuar edhe është provuar në javët e fundit, se anëtarë të këtij grupi kriminal kanë kanosur dhe shtrënguar disa shantosa për dhënie shumash të konsiderueshme parash.

'ANTIMAFIA' OPOZITA

PD, Alibeaj: Kontroll kontratave dhe vendimeve të zyrtarëve, edhe kryeministrit

"Antimafia", nga verifikimi, sekuestrimi e deri te sanksionet Propozimi, strukturë e posaçme antikorrupsion

Valentina Madani

Opozita i ka bërë ndryshime rrënjësore Ligjit Antimafia si goditje e fortë ndaj oligarkëve. Partia Demokratike zbardhi dhe mekanizmat e Ligjit Antimafia që nga verifikimi, sekuestrimi i pasurisë e deri tek sanksionet ndaj atyre që kanë përfutur në mënyrë abuzive. Opozitarët synojnë "çlirimin e ekonomisë nga monopolet", ndërkohë që deputeti Enkelejd Alibeaj theksoi se ky ligj nuk do të lejojë asnjë kontratë abuzive dhe se do të mbrojë pasurinë publike. Po kështu, ai paralajmëroi se në filtr do të kalojë çdo zyrtar publik që nga nëpunësi i thjeshtë deri tek kryeministri. Deputeti Enkelejd Alibeaj propozoi ndryshimet, të cilat sipas tij synojnë verifikimin, sekuestrimin e pasurive të personave dhe kompanive private dhe zyrtarëve publikë, të përfshirë në korrupsion, apo që kanë abuzuar me detyrën. Propozohet që subjektet që ligji i godet, të detyrohen të kthejnë pasurinë publike në gjendjen që ishte para firmosjes së kontratave, ndërsa përjashtohet nga çdo procedurë konkurruese për të paktën 20 vjet. Cilat janë mekanizmat ligjorë dhe institucionale, që Partia Demokratike propozon për verifikimin dhe sekuestrimin e pasurive të personave privatë dhe zyrtarëve publikë, të përfshirë në korrupsion? Deputeti Enkelejd Alibeaj prezantoi ndryshime rrënjësore në Ligjin Antimafia, që synojnë konfiskimin e çdo pasurie të kompanive private të fituara me kontrata korrupsive apo zyrtarëve publikë që kanë abuzuar me detyrën. "Çdo gjë e zhvatur, çdo gjë e përfutur në mënyrë abuzive do të duhet t'i rikthehet publikut, buxhetit të shtetit. Pasuri apo para publike", u shpreh z.Alibeaj. Opozita propozoi që ndryshimet në "Antimafia", të kenë edhe fuqi prapavpruese. "E reja që kemi sjellë në këtë plat-



Monopolet, opozita bën bilancin e abuzimeve PD, Tabaku: Biznesmenëve përfitues do u sekuestrohen pasuritë

Deputetja Jorida Tabaku foli dhe për bilancin e abuzimeve në sektorin e tenderave, koncesioneve, monopoleve, duke përmendur me emra kompanitë që sipas saj janë klientë të qeverisë. Deputetja demokrate bëri një ekspozitë të abuzimeve flagrante me fondet publike nga ana e qeverisë socialiste të kryeministrit Rama. Ajo renditi me shembuj dhe emra konkretë aferat kryesore të këtyre 5 viteve, përmes të cilave janë qindra milionë euro para publike, të cilat kanë shkuar në xhepat e klientëve të kryeministrit Rama. Tabaku përmendi rastin e të ashtuquajturit 'check up' falas dhe shumë raste



të tjera të abuzimeve me fondet publike apo modelin e ofertave të pakërkua, përmes të cilave po grabiten paratë e taksave të shqiptarëve. "120 milionë euro vijnë nga taksat e qarkullimit, por pavarësisht kësaj, qeveria preferon t'i japë

VERIFIKIMI
"Çfarë do të verifikohet? Çdo kontratë abuzive e koncesioni, çdo kontratë abuzive e prokurimit publik, çdo kontratë abuzive PPP, çdo kontratë e tjetërsimit të pasurive publike si shitje, dhënie me qira, dhënie për shfrytëzim për ndërtim. Bashkë me to edhe çdo akt administrativ, publik abuziv si leje, licenca, autorizime", deklaroi z.Alibeaj.

rrugët me koncesion. Ligji 'Fusha' për Teatrin është abuzimi më i freskët. Ofertat e pakërkua psh.. Kemi rastin e aeroportit të Vlorës, ku kompanisë turke iu miratua oferta e pakërkuar. Ndërtimi është një tjetër fushë abuzimi. Kemi rastin e një kompanie që merr 261 leje ndërtimi, ndërkohë që objekt i aktivitetit të saj janë lojërat e fatit. Kemi rastin estadiumit me kullë. Ofertat e pakërkua, model abuzimi, të cilat e kanë vrarë konkurrencën e lirë. Kompanitë e basteve të lidhura me ministrin e Brendshëm kanë rritur aktivitetet e tyre dhe fitojnë tenderat e monitorimit të tatimeve", deklaroi zj.Tabaku.

dimet e tyre edhe punonjësit e administratës nga më i ulëti deri tek më i larti. "Do t'i nënshtrohen këtij filtri,

këtij mekanizmi, çdo zyrtar publik nga nëpunësi më i thjeshtë e deri te kryeministri", u shpreh z.Alibeaj. Në

Në kuadër të zbatimit të projektit të dixhitalizimit të shërbimit notarial kombëtar për venien në funksionin të databazës shtetërore NISA. Dhoma Kombëtare e Noterisë (Dh.K.N.) from Operatorët Ekonomike të huaj ose vendas për të marrë pjesë në këtë procedurë.
Dokumentat e projektit mund të terhiqen përkundërt pageses prej **10.000 leke**, pranë Dh.K.N. në adresën Rruga Vaso Pasha, Tiranë, Shqipëri.
Propozimet do të pranohen brenda datës **7 tetor 2018 ora 10:00 AM**



Kryetari i PD-së, Lulzim Basha gjatë prezantimit të djeshëm të "Platformës antimafia" të PD

PROCESI
Ligji ngarkon strukturën e posaçme antikorrupsion për të udhëhequr të gjithë procesin, ndërsa subjektet e goditura janë të detyruara të kthejnë pasurinë publike në gjendjen që ishte para firmosjes së kontratave, ndërsa përjashtohet nga çdo procedurë konkurruese për të paktën 20 vjet.



PD, Mima: 2,18 miliardë euro, fatura totale e abuzimit qeveritar

Florion Mima, ish-ministri i Financave, bëri dhe prezente pasojat e abuzimeve qeveritare me fondet e buxhetit, të cilat sipas tij janë 2.18 miliardë euro. Mima theksoi se borxhi publik është rritur nga 71% në 87,5% të Prodhimit të Përgjithshëm Bruto, pra ka një rritje prej 16.5%. Deputeti Florion Mima tha se fatura totale e abuzimit në këto 5 vite qeverisje të socialistëve kap vlerën 2.18 miliardë euro. PD zbardhi hapat e Ligjit Antimafia, efektet që ai do të japë për të çliruar ekonominë nga korrupsioni dhe oligarkët. Opozita ka propozuar shprehimisht që paratë e përfutura në mënyrë korrupsive e klienteliste t'u kthehen qytetarëve, ashtu si dhe pasuritë publike si edhe që, zyrtarët publikë dhe kompanitë private të përgjigjen me pasurinë e tyre për përfitimet abuzive.

propozimin e demokratëve sanksionohet kontrolli për një kategori të gjerë kontratash. "Çfarë do të verifikohet? Çdo kontratë abuzive e koncesioni, çdo kontratë abuzive e prokurimit publik, çdo kontratë abuzive PPP, çdo kontratë e tjetërsimit të pasurive publike si shitje, dhënie me qira, dhënie për shfrytëzim, për ndërtim. Bashkë me to, edhe çdo akt administrativ,

publik abuziv si leje, licenca, autorizime", deklaroi z.Alibeaj. Ligji ngarkon strukturën e posaçme antikorrupsion për të udhëhequr të gjithë procesin, ndërsa subjektet e goditura janë të detyruara për të kthyer pasurinë publike në gjendjen që ishte para firmosjes së kontratave, ndërsa përjashtohet nga çdo procedurë konkurruese për të paktën 20 vjet.

Platforma kundër korrupsionit ekonomik, kreu i PD: Do e nxjerrim Shqipërinë nga kolapsi!

Antimafia, Basha: 20 kompanive përfituese do u konfiskojmë pasuritë

"Kuvendi, i përfshirë në rrjetin e pastrimit të parave të krimit"

ANGAZHIMI

"Opozita është e vendosur për të bërë vettingun e politikës. Ulja e taksave për bixhozin dhe ligji kriminal për shembjen e teatrit janë dy ligje që tregojnë vizionin e Ramës. Kjo vërteton korrupsionin e qeverisë dhe pastrimit e parave kriminale. Platforma 1 miliard, inceneratorët, koncesionet tregojnë se Edi Rama nuk ka asnjë fre", - tha Basha.



KUVENDI

Sipas kreu të PD-së, janë duke u aplikuar dy mënyra për pastrimin e parave të e pista në vendin tonë dhe ato po funksionojnë me lejen e Kuvendit të Shqipërisë. "Në Kuvend po legjitimohet pastrimi i parave të pista përmes industrisë së bixhozit dhe aferave korruptive të ndërtimit", - tha Basha.



Valentina Madani

Partia Demokratike prezantoi dje mekanizmin e masave antimafia për çlirimin e ekonomisë nga korrupsioni dhe oligarkia. Alternativa e PD ka për qëllim sekuestrimin e pasurive publike të fituara me kontrata në kundërshtim me ligjin. Kryetari i PD, Lulzim Basha prezantoi 'Platformën antimafia të PD', që sipas tij do të çlirojë Shqipërinë nga krimi dhe do t'i japë frymëmarrje ekonomisë. Sipas Bashës qëllimi është sekuestrimi i pasurive publike të fituara me kontrata në kundërshtim me ligjin. Kreu i PD-së bëri të qartë se do sekuestrohen pasuritë e personave publikë dhe privatë të përfshirë në afëra korruptive tenderë, koncesione, PPP. Sipas tij janë 20 kompani që kanë përfituar në kundërshtim me ligjin duke bërë të qartë se do t'u konfiskohen pasuritë. "Ne do të prezantojmë platformën antimafia që propozon mekanizmin ligjor dhe institucionale për evidentimin, sekuestrimin e pasurive të personave publikë dhe privatë të përfshirë në afëra korruptive tenderë, koncesione, PPP. Nëse një grusht njerëzish përfitojnë gjysmën e fondeve publike në mënyrë jo transparente për afëra që nuk sjellin asnjë përfitim publik, thënë ndryshe shërbimi më i madh është të kthejmë kushtet e konkurrencës së ndershme, zbatimin e ligjit", - theksoi kreu i PD-së.

AFERAT

"Do t'u takojë atyre që janë bërë palë në këto afëra korruptive që të provojnë pajafësinë e tyre dhe ligjshmërinë e aseteve të tyre, dhe së dyti, duke bërë të mundur që pavarësisht procesit penal juridik, pasuritë e vëna në këtë mënyrë t'i nënshtrohet procesit të verifikim-sekuestrim-konfiskimit", - u shpreh kreu i opozitës.

ABUZIMI

"Nëse një grusht njerëzish përfitojnë gjysmën e fondeve publike në mënyrë jotransparente për afëra që nuk sjellin asnjë përfitim publik, thënë ndryshe shërbimi më i madh është të kthejmë kushtet e konkurrencës së ndershme, zbatimin e ligjit", - theksoi kreu i PD-së.



Monitorimi i KLGJ, KLP, KED, nis gara për anëtarin e 5-të

Kuvendi shpalli dje Kgarën për anëtarin e 5-të të Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të Ligjit "për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë". Deri më tani për monitorimin e KLGJ, KLP dhe KED janë zgjedhur 4 anëtarë. Anëtarët e Komisionit do të jenë juristë që zgjidhen nga Kuvendi. Ndërkohë janë përcaktuar edhe kriteret për të konkurruar për anëtarë, ndërsa afati për dorëzimin e dokumenteve është deri më 15 tetor. Megenëse nuk është plotësuar numri i anëtarëve të Komisionit të Pavarur, Komisioni për Çështjet Ligjore, në datën 24.9.2018, ka marrë vendimin për hapjen e procedurës së aplikimit për një vend vakant për anëtar të Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të Ligjit nr. 115/2016. Komisioni i Pavarur përbëhet nga 5 anëtarë, profesionistë në fushën e të drejtës, që zgjidhen nga Kuvendi, dhe ka objekt të veprimtarisë së tij monitorimin e proceseve të përzgjedhjes së kandidatëve dhe të zgjedhjes dhe emërimit të anëtarëve të organeve të qeverisjes të sistemit të drejtësisë.

"Kryeministri e përmbysi vendin me drogë"

LSI, Vasili: Trump kundër drogës, Rama në krah të saj

Kreu i Grupit Parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili akuzoi dje kryeministrin Edi Rama se e ka humbur trafikun e qeverisë kundër trafikut të drogës. Vasili thekson se presidenti i SHBA-e Donald Trump shpalli publikisht luftën kundër drogës, ndërsa shton se këto fjalë për kryeministrin shqiptar janë ato që urren më shumë. Po ashtu Vasili tha se kryeministri e përmbysi Shqipërinë me drogë. "Trump ballas kundër drogës ndërsa Rama në krah të saj dhe kundër Trump. Donald Trump në OKB shpalli publikisht se SHBA do të zhvillojë një betejë dhe një luftë nga me



agresivitet ndaj drogës si shkatërrimtare e shoqërisë, shëndetit dhe ekonomisë. Për Trump kjo betejë është prioritet madhor mbarë botëror. Për kryeministrin e Shqipërisë fjalët "luftë ndaj drogës", janë pikërisht

fjalët, që ai urren më shumë, sepse kryeministri vetë është ai që gjallon, vegjeton dhe qeveris përmes drogës, me drogën dhe për drogën. Kryeministri e përmbysi Shqipërinë me drogë dhe për përdorimin e kokainës e radhitë si vendin e parë. Mbi këtë kryeministër rëndojnë fatet e mijëra familjeve të shkatërruara, mijëra familjeve të kriminalizuara të përfshira në kultivim dhe trafik droge dhe mijëra jetëve me shëndet të shkatërruar nga përdorimi i drogës. Trump është përballë drogës ndërsa Rama në krah të saj, pra kundër Trump...", shprehet Vasili.

atyre që janë bërë palë në këto afëra korruptive që të provojnë pajafësinë e tyre dhe ligjshmërinë e aseteve të tyre, dhe së dyti duke bërë të mundur që pavarësisht procesit penal juridik, pasuritë e vëna në këtë mënyrë t'i nënshtrohet procesit të verifikim-sekuestrim-konfiskimit", - u shpreh kreu i opozitës. Basha bëri të qartë se të gjitha paratë e marra nga oligarkët do t'u kthehen qytetarëve shqiptarë. "Pa ndaluar këtë të keqe dhe pa i rikthyer shqiptarëve paratë dhe asetet që po vid-

hen përditë, nga një qeveri e bërë njësh me krimin, as sipërmarrja nuk do të shohë asnjë ditë të bardhë, as qytetarët shqiptarë nuk do të mund të dalin nga spiralla e të keqes që i ka mbërthyer", - theksoi z.Basha.

AKUZAT

Në konferencën "Çlirimi i ekonomisë, platforma kundër korrupsionit dhe oligarkisë", Basha deklaroi se "marrëdhënia mes krimit dhe politikës ka avancuar edhe në ekonominë shqiptare". "Shqipëria është një gjendje kolapsi. Një krizë e

trefishtë; ekonomike, politike dhe morale ka pushtuar vendin. Demokracia ka rënë për hesap të aleancës mes krimi dhe qeverisë, ka kapur ekonominë dhe drejtësinë. Kemi propozuar platformën e vettingut politik, si dalje nga emergjenca. Vetingu politik nuk është asgjë më shumë se vetingu i gjyqtarëve dhe policëve. Rama është kundër vettingut në politikë, pavarësisht se ka votuar të njëjtat dispozita ligjore për vettingun në drejtësi. Rama i konsideron politikanët speciale dhe mbi

DEPUTETI I PD-SË I BASHKOHET PROTESTËS SË NXËNËSVE NË ELBASAN

Deputeti i PD-së, Luçiano Boçi, iu bashkua dje nxënësve në Mëngëll të Elbasanit, të cilët prej një jave nuk bëjnë mësim në shkollën e tyre. Ata kanë bojkotuar procesin mësimor duke kërkuar rikthim në shkollën që tani më rezultojnë të jetë në gjendje të mirë. Për këtë Boçi bëri fjalë të mirë, që sipas tij me arrogancën dhe stafin e papërgjegjshëm kanë sjellë këtë situatë absurde. "Megjithatë sot fëmijët i kanë dhënë flakuninën e parë të hidhur turinje, kësaj papërgjegjshmërie e prepotence", shkruan deputeti i PD-së Luçiano Boçi.



ligjin. Opozita është e vendosur për të bërë vettingun e politikës. Ulja e taksave për bixhozin dhe ligji kriminal për shembjen e teatrit janë dy ligje që tregojnë vizionin e Ramës. Kjo vërteton korrupsionin e qeverisë dhe pastrimit e parave kriminale. Platforma 1 miliard, inceneratorët, koncesionet tregojnë se Edi Rama nuk ka asnjë fre", deklaroi Basha. Sipas tij, Kuvendi po legjitimohet pastrimi i parave të pista përmes industrisë së bixhozit dhe aferave korruptive të ndërtimit.

PARLAMENTI PËRPLASJA

Darina Tanushi

Maxhoranca miratoi dje, e vetme pa praninë e opozitës 3 ligje me 71 vota. Ndër to ish-edhe ligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8318, datë 1.4.1998, "Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore", të ndryshuar", për të cilin kreu i Grupit Parlamentar të PS-së, Taulant Balla pati një përplasje në distancë me deputetin e LSI-së Edmond Panariti. Gjatë fjalës në Kuvend, Balla u shpreh: "Nuk mund të hesht pa risjellë në vëmendje disa problematika që lidhen me abuzimet 27-vjeçare të dhënies së tokave me qira në Shqipëri, për të cilat z. ministër unë mendoj se ne duhet të sjellim një ligj tjetër të ri, për t'i riparë të gjitha kontratat e dhënies me qira të tokave".

"Jo të gjitha tokat e dhëna me qira sot janë në shfrytëzim. Përkundrazi, kemi dhe raste të cilat KU unë e përhëndes angazhimin tuaj personal në një kontratë të firmosur nga paraardhësi juaj, z. Panariti me familjen Balili, që ende nuk ka marrë zgjidhjen e duhur për shkak se kontrata është qepur aq mirë. Por unë mendoj se ligji duhet të jetë i fortë edhe në këtë rast. Nuk mund që nga njëra anë Balilëve t'u sekuestrojmë hotelin dhe nga ana tjetër 90 ha tokë të marra me qira nga shteti të mos kemi mundësi t'ia sekuestrojmë", u shpreh Balla. "Edmond Panariti, ish-ministri i Bujqësisë i Lëvizjes Socialiste për Integrim, ka firmosur atë kontratë. Por kjo nuk mund të jetë sot e vlefshme në rast se ne nuk gjejmë hapësirat ligjore që atë kontratë ta bëjmë të pavlefshme. Kjo e bën qesharake opozitën turistike, e cila edhe sot nuk gje-ti mundësinë që të ishte në sallën e Kuvendit të Shqipërisë për të diskutuar për një çështje reale, sikurse janë problemet e tokave bujqësore, por vijoi turin e radhës në hotelin turistik të radhës", tha më tej kreu i grupit parlamentar. E duke iu drejtuar ministrit Niko Peleshi, Balla u shpreh: "Z. ministër edhe diçka tjetër, për shkak se Ministria e Bujqësisë është qeverisur katër vitet e shkuara nga ish-aleati ynë Lëvizja Socialiste për Integrim, por edhe për shkak se në tërë vitet përpara 2013-ës është bërë një abuzim jo vetëm me tokat bujqësore, por edhe me liqenet, duhen parë të gjitha kontratat". "Sot shqiptarët do të dëgjojnë historinë tjetër qesharake të pseudo-opozitës sonë me gjoja propozime anti-mafia, luftë oli-

Kuvendi miraton ligjet me 71 vota, kreu i grupit të PS akuzoi ish-ministrin të LSI

Dhënia e tokave me qira, Balla: Panariti firmosi kontratë me Balilët

Përgjigjet ish-ministri: Ky është mashtrim, verifikojeni




Kreu i grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla

SHTYRJA

Deputetët e maxhorancës kanë shtyrë për të disatën seancë dy nga ligjet që kërkojnë 84 vota. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" si dhe projektligji "Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar" nuk kaluan as në seancën e djeshme.

Gjatë një seance parlamentare



Blerja e Eurobondit, Rama: Opozita rrugëhumbur

Kryeministri Edi Rama përmes një statusi në rrjetet sociale shprehet se Shqipëria u listua dje, në tregjet ndërkombëtare të kapitalit për blerjen e Eurobondit, ndërsa paralajmëron se do të ketë sukses për disa arsye. "Sot (dje)paradite Shqipëria u listua në tregjet ndërkombëtare të kapitalit për blerjen e Eurobondit dhe ne do të kemi sukses në këtë operacion, pikërisht sepse ekonomia, financat e qeverisja jonë, janë krenjë e kundërta e atyre që thotë pasqyra e dëshpërimit të opozitës sonë rrugëhumbur!", u shpreh Rama. Ligji kaloi me shpejtësi jo të zakonshme në parlament të enjten, ku u depozitua si projektligj vetëm më 17 shtator. Kjo lidhet edhe me faktin se, sipas njoftimeve zyrtare, vitin e ardhshëm shteti shqiptar do të ndodhet përballë një nevojë likuiditeti shtesë prej të paktën 700 milionë eurosh. Qeveria mendon se emetimi i Eurobondit në tregjet ndërkombëtare në vitin 2018, me madhësi maksimumi deri në 500 milionë euro, me afat maturimi 5-10 vjet vlerësohet si mënyra optimale si për të plotësuar nevojat për financim për dy vitet në vijim, ashtu edhe për të mundësuar optimizimin e menaxhimit aktiv të detyrimeve të borxhit në periudhën afatshkurtesë dhe afatmesme. Në këtë Eurobond synohen të futen disa elemente të reja si zgjerimi i formatit për të rritur aksesin në tregjet e SHBA-ve përveç tregjeve evropiane.



Spiropali, thirrje opozitës: Kthehuni në Kuvend, do të keni fat tragjik

Deputetja e PS-së, Elisa Spiropali, nga Kuvendi i ka bërë thirrje opozitës që të rikthehen. Në fjalën e saj, Spiropali e ka krahasuar grupin opozitar me një shfaqje tragjedi, atë të Makbethit. "Nëse opozita do të vinte një shfaqje do të ishte Makbethi. Sepse ata piqen në salla, ngajjnë si pika uji me korin e magjistriceve. Gjuha e helmatisur e opozitës zbardh të zezën dhe nxin të bardhën. Këta duan t'u bërtasin në fytyrë 'I kni se Shqipëria nuk bëhet'. Kronikë e zezë përzier me fake-news", u shpreh Spiropali, gjatë fjalës në Kuvend. Ajo mori dy shembuj. "Fyerjet e papërbal-



lueshme për prokurorinë, Arta Markun dhe policinë e shtetit. Kur një grua është e fortë ata mundohen që ta fyejnë, llangosin. Ajo po ia del që të godasë grupet kriminale. Reforma në drejtësi po ngre një katedrale të re në gjyqësor. Ata të vijnë këtu për të bërë detyrën për të cilën janë votuar", u shpreh

Spiropali. Sipas saj, opozita nuk la gjë pa thënë për Policinë e Shtetit. "Nuk vijnë këtu të flasin. E vetmja gjë që duan të bëjnë është nxirja e realitetit. Në momentin që një bandë e vërtetë kapet, ata heshtin. Merrren vetëm me kronikën e zezë. Ky është vizioni i tyre! Njerëzit kanë nevojë për shpresë, ata duan t'ua thajnë shpresën. Jemi në fundin e një beteje që nisi nga PS, një reformë që askush nuk vultë baste dhe shpresonte. Kjo ka shkaktuar një çoroditje të përgjithshme. Ajo që dua të them është ashtu si në një tragjedi që nuk ka asnjëherë dalje. T'i kthehen Kuvendit", u shpreh Spiropali.

garkëve. A mund ta besojë kush në Shqipëri që mund të bëjë luftë kundër oligarkëve gjobaxhii i oligarkëve, Lulzim Basha? Lulëzimi përpara se të marrë përsipër që të drejtojë gishtin tek vëllezërit e secilit prej nesh, te kuletërit e secilit prej nesh, duhet të sqarojë i pari ai marrëdhënien e kumatit të tij me të gjithë kompanitë e oligarkëve, pastaj hajde këtu në Kuvend e të bëjmë gdo lloj ligji. Nuk mund të bësh ligj ti Lulzim nëpër hotele, sallat e të cilëve nuk di kush t'i

paguan. Një tur turistik gjithë shtatorin pa e ditur ende se kush paguan dhe si paguhet. Sa për luftën kundër oligarkëve, kundër përfshirjes së kriminalitetit, nuk ka përgjigje më të mirë sesa Byroja Kombëtare e Hetimit dhe Prokuroria Speciale Anti Korrupsion, u shpreh Balla.

REAGIMI

Deputeti i LSI-së, Edmond Panariti, i është përgjigjur akuzave të Taulant Ballës. Përmes një statusi, Panariti shkroi se kjo është lehtësisht

e verifikueshme, duke deklaruar se tashmë publiku e ka të qartë e kush shoqërohet me trafikantët. "Nuk ka kontratë të lidhur as nga Ministria e Bujqësisë dhe as nga Edmond Panariti me trafikantët Kelmend Balili... zoti Taulant Balla!! Ky është një mashtrim... lehtësisht i verifikueshëm dhe i hetueshëm... Keni një vit që vetëm hetoni dhe auditoni procese dhe procedura për të cilat janë shprehur që nga KLSH e me radhë. Vazhdoni!! Por, se kush shoqërohet me

trafikantët dhe madje e deklararon hapur këtë, publiku e ka tashmë të qartë. Por kjo nuk mundimmon në fsheshjen e dëshimit spektakolar të Bujqësisë, në vitin tuaj të tepsisë", thekson Panariti. Gjithashtu, de-

puteti i LSI-së nënvizoi se fjalët dhe retorika boshe e Ballës, nuk fsheh aspak dëshitim katastrofik në sektorin e bujqësisë. Panariti jep edhe shifra, të cilat tregojnë performancën e sektorit në fjalë.

Zyra e Përmbarimit Albitus, me përmbartës gjyqësor privat Zef Macaj, në bazë të vendimit nr. 1857, datë 19 Shtator 2018, shpall shijën në ankand të pasurisë pasurisë "Ndërtesa", me sipërfaqe 115 m², me numër pasurie 6/596/ND, volumni 37, faqe 111, zona kadastrale nr. 8120, me adresë: Rr. "Niko Avrami", Tiranë, në vlerën 43,361.6 (dyzet e tre mijë e treqind e gjashtëdhjetë e një, pikë gjashtë) Euro.

Ankandi zhvillohet në ambientet e Zyrës të Përmbarimit Albitus, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa nr. 6, Hyrja nr. 3, Apartamenti nr. 8, Njësia Administrative nr. 10, 1001, Tiranë, ditën e Enjte, me datë 19 Shtator 2018, ora 16.15.



Presidenti: Nxitja e dialogut politik, mënyrë e mirë për promovimin e shoqërive me rregulla

Samiti i Paqes, Meta në OKB: Shqipëria mbështet axhendën e ndaljes së konflikteve

"Theksi të vihet te të drejtat e njeriut"

Darina Tanushi

Presidenti i Republikës, Ilir Meta mori pjesë dhe përshëndeti me një fjalim Samitin e Paqes "Nelson Mandela" të mbajtur në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, që po zhvillohet në Nju-Jork. Shqipëria e ka mbështetur gjithnjë axhendën e ndaljes së konflikteve, u shpreh në fjalën e tij përshëndetëse, Presidenti shqiptar. "Dua të theksoj se të drejtat e njeriut janë shumë të rëndësishme për ruajtjen e paqes. Na duhet paqja mes vendeve në bashkëpunim me njëri-tjetrin. Shqipëria e ka mbështetur këtë axhendë në mënyrë që të ndalohen konfliktet e të vendoset paqja. Dialogu politik na ndihmon të vendosim paqen e të respektojmë të drejtat e njeriut. Nëse shkelen këto atëherë çdo gjë ka ndryshuar. Kjo është një nga shprehjet e Nelson Mandelas", tha Meta.

"Në Shqipëri ne kemi pasur 'Mandelat' tonë, të cilët për dekada me radhë gjatë regjimit komunist, janë përndjekur mazorisht e pa mëshirë dhe janë privuar nga liria, për shkak të ideve dhe besimeve të tyre. Por ata mbijetuan për të na treguar dhe për të na inkurajuar që të jemi më tolerant për besimet, fenë dhe etninë e njëri-tjetrit", theksoi Presidenti. "Ndërsa ne flasim këtu, në mbarë botën ka ende shumë konflikte të dhunshme, si dhe mundësi të ndryshme për luftë që duhet të parandalohen si dhe kriza humanitare që duhen të përballen e tejkalohen. Ka shumë shkelje të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, dhe qëllimi ynë për paqen globale ende nuk është arritur. Në mes të gjitha këtyre dimensioneve të paqëndrueshmërisë, ekziston trashëgimia e njerëzve që kanë luftuar për paqen dhe për një të ardhme paqësore", - tha Meta. "Sot ne po kërkojmë mënyra të reja për të promo-



Presidenti i Republikës, Ilir Meta

GJENERALI BRITANIK

"Shqipëria luan rol kyç në mbështetje të përpjekjeve të Mbretërisë së Bashkuar për të bashkuar aleatët dhe ne jemi mjaft mirënjohës për këtë mbështetje, sikundër për ngrohtësinë dhe mikpritjen që na tregohet nga Forcat e Armatosura dhe shqiptarët", tha gjenerali major Stickland.

vuar sa më mirë qëndrueshmërinë e paqes dhe për ta përdorur sa më mirë parandalimin e konflikteve në një perspektivë afatgjatë. Në këtë drejtim, Shqipëria vëren se kemi nevojë për një qasje të gjithë shoqërisë njerëzore, të mbështetur nga institucione të forta dhe sundimi i ligjit, siguria njerëzore, zhvillimi përfshirës dhe qëllimi i plotë i të drejtave të njeriut për të gjithë njerëzit", - nënvizoi Kreu i Shtetit. "Në prag të përvjetorit të 70-të të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, dëshiroj të theksoj se të drejtat e njeriut përbëjnë me të vërtetë

një bazë kritike për paqen dhe se elasticiteti ka hedhur spirancën dhe është ankoar në sinergji e shoqërive tona", - tha Meta. "Meqenëse të drejtat e njeriut janë universale, ato përbëjnë shtyllën kurizore të shoqërive tona në ndërtimin e paqes dhe garantimin e sigurisë dhe qëndrueshmërisë. Zbatimi i Axhendës 2030 dhe qëllimi i saj për nxitjen dhe mëkëmbimin e shoqërive paqësore, të drejta dhe gjithëpërfshirëse na çojnë drejt promovimit të parandalimit si



TAKIMI

Presidenti i vendit, Ilir Meta, pas takimit me komunitetin shqiptar në kishën "Zoja e Shkodrës", ka takuar edhe kryetarin e Bordit të Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve, Michael Granoff në Nju Jork. Meta është shprehur mirënjohës për mbështetjen që AADF u ka dhënë bizneseve shqiptare dhe se kontributi i saj ka forcur miqësinë mes dy kombeve.

Xhaçka: Baza Ajrore e Kuçovës, e vetmja bazë e NATO-s në Ballkanin Perëndimor

1200 ushtarakë shqiptarë dhe të ardhur nga Britania e Madhe, Kroacia e Kosova ushtruan sot në sheshin "Nënë Tereza", një demonstrim të përgatitjes fizike, por edhe të mjeteve ushtarake, në kuadër të stërvitjes "Albanian Lion 2018". Në ceremoninë e zhvilluar, Ministria e Mbrojtjes Olta Xhaçka theksoi rëndësinë e kësaj stërvitjeje. "Zhvillimi i kësaj stërvitjeje është demonstrim i vullnetit të përbashkët të vendeve tona për të bashkërenduar përpjekjet e për të rritur shkallën e profesionalizmit, aftësinë ndërvepruese dhe kohezionit ndërmjet Forcave tona të Armatosura, për përballimin e sfidave të përbashkëta dhe rritjen e sigurisë dhe të cilësisë së jetës së qytetarëve tanë", u shpreh Xhaçka. Një nga risitë e kësaj stërvitjeje të përbashkët është se për herë të parë u bë pjesë edhe Forca për Sigurinë e Kosovës. Ministria deklaroi se vitin tjetër pjesëmarrja në "Albanian Lion" do të 5-fishohet. Më tej në fjalën e saj, ministria Xhaçka u shpreh se Shqipëria mbetet vend me kontribute të geneshme në NATO. "Vendimi i Këshillit të Atlantikut të Veriut, për të financuar realizimin e projekteve të përbashkëta me Aleancën për modernizimin e Bazës së Kuçovës dhe kthimin e saj në një bazë të NATO-s, është konfirmim i rolit dhe përgjegjësisë së vendit tonë, dëshmon peshën dhe përparësinë që përfaqëson Shqipëria për sigurinë dhe paqen në rajon, duke marrë në konsideratë faktin që Baza Ajrore e Kuçovës është e vetmja bazë e NATO-s në Ballkanin Perëndimor", u shpreh Xhaçka. Në këtë aktivitet mori pjesë edhe Gjenerali Major Charles Stickland, komandant i Marinës Mbretërore të Mbretërisë së Bashkuar. "Shqipëria luan rol kyç në mbështetje të përpjekjeve të Mbretërisë së Bashkuar për të bashkuar aleatët dhe ne jemi mjaft mirënjohës për këtë mbështetje sikundër për ngrohtësinë dhe mikpritjen që na tregohet nga Forcat e Armatosura dhe shqiptarët. Kjo stërvitje është mundësi për forcat e marinës mbretërore për të kontribuar dhe për të vlerësuar gatishmërinë luftarake të vendeve të NATO-s për vitin 2019", tha gjeneralmajor Stickland.



STUDIO PËRMBARIMORE GJYQËSORE "KREON" me PËRMBARUESE GJYQËSORE SUELA METHOXHA

Dt. 25.09.2018 ora 16:00
Përfundon Ankandit i Parë për pasuritë:
- Pasuria "Lokali nr. 4" me sip. 66 m², me adresë L. 13, Plazh Durrës.
Me çmim 66 000 Euro
- Pasuria "Lokali nr. 5" me sip. 43 m², me adresë L. 13, Plazh Durrës.
Me çmim 51 600 Euro
- Pasuria "Lokali nr. 6" me sip. 110 m², me adresë L. 13, Plazh Durrës.
Me çmim 140 800 Euro
Ankandit Zhvillohet në zyrën e STUDIO PËRMBARIMORE GJYQËSORE "KREON", me adresë: L.11, Biv.kryesor (ish kinma Iliria), Kati-2, Durrës, Kontakti Cel 0682096575

SHOQËRIA PËRMBARIMORE PRIVATE "E.P.S.A" SHPK NJOFTIM SHPALLJENË ANKANDIT PËR:

1- "Pylj + Kullorë" me sip. 280.000 m². Nr. hipotekor 168 datë 29.05.2012. ZK 3028, e ndodhur në Poro, Vlorë. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të Bankës Raiffeisen sh.a. Çmimi me të cilin filloi ankandit është 3.024.202 Euro. Ankandit zhvillohet datë 22.10.2018 ora 16.00 në adresën Rr. "Osmali" Pall. "Fratar", K.6, Tiranë.
2- "Pylj + Kullorë" me sip. 95.000 m². Nr. hipotekor të datë 25.03.2009. ZK 3028, e ndodhur në Poro, Vlorë. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të Bankës Raiffeisen sh.a. Çmimi me të cilin filloi ankandit është 1.026.660 Euro. Ankandit zhvillohet datë 22.10.2018 ora 16.00 në adresën Rr. "Osmali" Pall. "Fratar", K.6, Tiranë.
3- "Frull" - Ndërtimi me sip. 3.220 m² nga Kjo 1415.5 m² ndërtimi me adresë Shkollë, Durrës. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të Bankës Raiffeisen sh.a. Çmimi me të cilin filloi ankandit është 490.89 Euro. Ankandit zhvillohet datë 17.10.2018 ora 16.00 në adresën Rr. "Osmali" Pall. "Fratar", K.6, Tiranë.
4-PKë pasuritë me Nr.1973-15, vdi.41, fq.85, ZK.9531, me sip.119,2 me adresë Rr. "Mucq175", Durrës. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të Bankës Raiffeisen sh.a. Çmimi me të cilin filloi ankandit është 36.036 Euro. Ankandit zhvillohet datë 17.10.2018 ora 16.00 në adresën Rr. "Osmali" Pall. "Fratar", K.6, Tiranë.
Për çdo informacion kontaktimi në tel. 04 2562711 ose në www.epsa.al

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PËRMBARIMORE GJYQËSORE PRIVATE "ILIA ELEZI"

PASURIA ME NR. 27/1, E LLOJIT "ARË", VOLUMI 1, FAQJE 169, ZONA KADASTRALE 3852, SIPERFAQJE 4.453 m², ME ADRESËN: XHAFTOTAJ, DURRËS, NË PRONËSI TË Z. NEXHMI VORA,

ÇMIMI 17.600.000 LEKË. Data e zhvillimit të ankandit do jetë 08.10.2018.
CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

Zbardhet drafti, katër kategoritë e mjeteve që do të lejohen të hyjnë në vend pas 1 janarit

Projektvendimi/ Si do ndalohet importi i makinave më të vjetra se 10 vite

Edhe automjetet nën 'EURO 5' s'do të hyjnë më në Shqipëri

Ornela Manjani

Automjetet e prodhuara para vitit 2009 dhe automjetet që nuk përmbushin normën 'EURO 5' dhe lart nuk do hyjnë në vendin tonë pas datës 1 janar 2019. Në vend do të lejohet importi i katër kategorive automjetesh. E para autoveturat e reja me zero km dhe që nuk janë regjistruar më parë për qarkullim në asnjë shtet tjetër, të cilat përmbushin normën 'EURO 5', të Bashkimit Europian. Kategoria e dytë janë mjetet motorike të tjera të reja si: motorë, autobusë, kamionë të kategorive M2 dhe N1, me zero km dhe që nuk janë regjistruar më parë për qarkullim në asnjë shtet tjetër, të cilat përmbushin normën 'EURO 5', të Bashkimit Europian. Kategoria e tretë autoveturat e përdorura (të gjitha ato që nuk janë me zero km dhe që janë regjistruar më parë për qarkullim në rrugë në një shtet tjetër) duhet të jenë prodhuar jo më shumë se 10 vjet para datës së regjistrimit të parë në Shqipëri. Kategoria e katërt janë mjetet motorike të



tjera të përdorura si motorë, autobusë, kamionë, të kategorive M2 dhe N1, (të gjitha ato që nuk janë regjistruar më parë për

qarkullim në rrugë në një shtet tjetër) duhet të jenë prodhuar jo më shumë se 10 vjet para datës së regjistrimit të parë në Sh-

qipëri. Përcaktimet janë bërë në projektvendimin që Ministria e Mjedisit ka gati dhe pritet ta nisë për miratim. Sipas këtij projektvendimi, automjetet që janë prodhuar më shumë se 10 vjet më parë dhe për makinat e reja, ato që nuk përmbushin normën 'EURO 5' dhe lart, nga 1 janari nuk do të lejohet që të hyjnë në Shqipëri. Ndërkohë nuk do të ndalohet importi i automjeteve të hershme me interes historik dhe koleksionimi (p.sh. automjete të prodhuara deri në dhjetor 1970). Për motorët dhe kamionët, koha e lejuar për importin e tyre nga data e prodhimit është 15 vjet. Nisur nga ligji nr. 162/2014 "Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedis, qeveria ndërmoi hapa për ndalimin e importit të makinave të vjetra, me qëllim reduktimin e shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë. Sipas relacionit që shfaqet në projektvendimin mësohet se deri në vitin 2016 në vendin tonë ishin të regjistruara 435.613 autovetura. Numri total i automjeteve (duke përfshirë edhe kamionët, autobusët, motorët, rimorkiot, makinat bujqësore, etj.) ishte 562.658. Sipas DPSHTRR-së ka edhe rreth 200.000 autovetura të tjera që formalisht nuk janë në qarkullim, pra nuk kanë bërë reregjistrimin në momentin e kontrollit teknik. Kjo do të thotë se numri i automjeteve të përdorura që janë gjendje në vend është akoma më i madh. Vitet e fundit, struktura e regjistrimit për herë të parë të autoveturave është: 5% mjete të reja (kilometrazh 0) dhe 95% mjete të

AUTOMJETET QË PËRJASHTOHEN

Sipas specifikimeve të pr. vendimit, ky vendim zbatohet për mjetet motorike të kategorisë M (M1, M2) për transport njerëzish dhe N (N1) për transport mallrash. Ky vendim nuk zbatohet për importin e:

1. Automjeteve të hershme me interes historik dhe koleksionimi, siç janë;
2. Automjete të prodhuara deri në dhjetor 1970;
3. Automjete të prezantuara si model i prodhimit deri me 31 dhjetor 1970, pavarësisht vitit aktual të prodhimit të një automjeti të veçantë, ose automjete, të cilët paraqesin vlera teknike muzeore apo kulturore, trashëgimi tradicionale.

Çdo të ndodhë me automjetet që kanë hyrë tashmë?

Projektvendimi parashikon që automjetet, të cilat me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, kanë hyrë në territorin shqiptar, por nuk kanë përfunduar procedurat e regjistrimit, kanë afat deri në 31 dhjetor 2018, për kryerjen e procedurave të nevojshme.

përdorura e shumë të përdorura. Kjo prijte u theksua pas vitit 2011, kur me eliminimin e taksës doganore u hoq edhe barrierat taksuese që ishte vendosur për efekt të ndotjes nga mjetet e përdorura. Me heqjen dorë nga parimi "ndotësi paguan" u ndryshua rrënjësisht politika e importit të automjeteve. Një shifër e tillë e regjistrimit të mjeteve të reja (5%) nuk haset në asnjë vend të Evropës, ndoshta edhe të Afrikës. Kjo çon në mosrespektim të normave të lejuara të shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull të përcaktuara në Direktivat e Bashkimit Evropian dhe në konventat e ndryshme ndërkombëtare. Aktualisht vazhdojnë të regjistrohen për herë të parë edhe makina 'EURO 0', 'EURO 1', 'EURO 2' e 'EURO 3', duke krijuar në këtë mënyrë probleme të mprehta të ndotjes së mjedisit e sigurisë në rrugë. Mjetet 'EURO 0-3' përbëjnë 80% të parkut ekzistues. Ligji Nr. 10458, datë 21.07.2011 "Për disa ndryshime në ligjin Nr. 9975, datë 28.07.2008, "Për taksat kombëtare, i ndryshuar" e riorganizoi sistemin e taksave që zbatoheshin për mjetet motorike. Taksimi i padiferencuar i pranuar nga ky ligj, e ka nxitur e vazhdon ta rëndojë gjendjen. Një mjet 'EURO 1' që çliron në atmosferë 31 herë më shumë grimca të ngurta (PM) e 12 herë më shumë okside azoti (NOx) se një mjet 'EURO 6', taksohet njëllëj me këtë të fundit. Vlen të përmendet se çmimi më i lirë i autoveturave të vjetra mund të rrisë intensitetin e transportit privat, duke çuar edhe prej këtij fakti, në rritje të sasisë së gazeve të dëmshme për frymë të popullsisë. Moshë mesatare e mjeteve në qarkullim në vendin tonë është mbi 20 vjet. Edhe këtë vit moshë mesatare e makinave që importohen vazhdon të jetë mbi 13 vjet e atyre u mbeten vetëm 5 vjet për t'u përdorur. Në 90% të rasteve kilometrazhi i mjeteve të importuara është i trukur, çka e rëndon edhe më tej gjendjen. Mbi 2/3 e mjeteve që importohen kanë përfunduar ciklin e tyre normal të jetës dhe si të thashë vijmë vetëm për "të vdekur" në Shqipëri. Po thellohet me shpejtësi hendeku që na ndan në këtë fushë nga vendet e BE-së dhe vendet e tjera të rajonit.



This project is funded by the European Union



Albanian National Training and Technical Assistance Resource Center

CALL FOR PROPOSALS

Terre des hommes Albania (Tdh) in partnership with the Albanian National Training and Technical Assistance Resource Centre (ANNTARC) are jointly implementing the project: "Strengthening Civil Society to Prevent and Protect Children from Abuse and Violence in Albania", financed by the European Union.

The overall objective of this EU project funded under the European Instrument for Democracy and Human Rights is:

- Strengthen child rights civil society organizations (CSOs) capacities and their role in child protection and family strengthening through structured capacity building programmes and technical assistance.
- Empower child rights CSOs to be drivers of change through development and advocacy of child protection and family strengthening models and good practices through a sub-grants scheme, networking, establishing a network of CSO trainers, monitoring and advocacy.

In this framework the 1st Round of Call for Proposal under the Sub-Granting Scheme is publicized and effective from **September 3rd, 2018** until **October 5th, 2018**. The overall amount made available under this Call for Proposals is **98,000 EUR**.

Tdh Albania aims to award around **7 (seven)** projects, which must fall between the following minimum and maximum amounts:

- Medium size sub-grants (10,000 -14,000 EUR) (up to 7);

The deadline for the submission of applications is **October 5th, 2018 at 17:00 hrs.**

The application package and related information must be found to the following links: www.childhub.org; www.tdh.ch; www.eeas.europa.eu/delegations/albania; www.antarc.org; Terre des hommes Albania and Terre des hommes Europe Facebook profiles.

KËSHILLI BASHKIAK PROPOZIMET

Mbledhja e Këshillit Bashkiak të Tiranës, shqyrtim i vendimeve me karakter social

Voltiza Duro

Në datën 27 shtator do të mbahet mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak të Tiranës, ku priten të miratohen një sërë vendimesh me karakter social në ndihmë të kategorive në nevojë. Respektivisht do të bëhet shqyrtimi për projektvendimin për dhënien e ndihmës ekonomike për 2599 familje në kryeqytet, si dhe për projektvendimin për miratimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe invalidët e punës. Ndërkohë, gjatë mbledhjes së Këshillit Bashkiak të Tiranës pritet miratimi i kompensimit të çmimit të energjisë elektrike për kategoritë përfituese për periudhën 1-31 gusht 2018. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot përmbledhjen e bordrosë së kompensimit të energjisë për ndihmën ekonomike për përfituesit gjatë periudhës së sipërpërmendur. Sipas vendimit të Këshillit të Ministrave, individët përfitues të statusit të invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik si dhe të verbër që kanë nevojë për kujdestar do të marrin një kompensim prej 2 mijë lekësh në muaj.

KOMPENSIMET

Ndërkohë, një kompensim prej 1400 lekësh në muaj do e përfitojnë të gjithë ata persona të verbër, si dhe përfituesit e statusit të invalidit që nuk kanë nevojë për kujdestar. Ndërkohë, theksohet se individët përfitues të statusit të invalidit dhe të verbër, që kanë nevojë për kujdestar do të marrin një kompensim prej 1 mijë le-

Projektvendimi: Kompensim i faturave të energjisë elektrike

Masat e përfitimit për secilën kategori



Këshilli Bashkiak i Tiranës gjatë një mbledhjeje

MASA E PËRFITIMIT

Një kompensim prej 1400 lekësh në muaj do e përfitojnë të gjithë ata persona të verbër, si dhe përfituesit e statusit të invalidit që nuk kanë nevojë për kujdestar. Ndërkohë, theksohet se individët përfitues të statusit të invalidit dhe të verbër, që kanë nevojë për kujdestar do të marrin një kompensim prej 1 mijë lekësh në muaj për faturën e telefonisë fikse.

kësh në muaj për faturën e telefonisë fikse. Kategoritë që përfitojnë kompensim për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 900 kwh në muaj janë edhe: familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike, kryefamiljarët që përfitojnë pension invaliditeti shtetëror dhe pension invaliditeti të plotë në fshat me

anëtarë të papunësuar, kryefamiljarë që përfitojnë pension pleqërie shtetëror, pension pleqërie fshati ose pension social. Gjithashtu, edhe familjet e punonjësve buxhetorë me pagë bruto nën 35 mijë lekë në muaj, që nuk kanë anëtarë të tjerë të punësuar apo vetëpunësuar përfitojnë nga ky kompensim i energjisë. Nga ky i fundit

parashikohet të përfitojnë edhe të verbër, personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë si dhe kryefamiljarët që përfitojnë pension të plotë pleqërie ose pension social me banim në fshat, kur familja është e përbërë vetëm nga pensionistë. "Në rastet kur në të njëjtën familje ka dy pensionistë të vetëm dhe kontrata është në emër

të pensionistit jokryefamiljar, kompensimin e përfiton pensionisti në emër të të cilit është kontrata e energjisë elektrike. Në rastet kur si e ardhur e vetme e familjes është pensioni familjar dhe kontrata është në emër të kryefamiljarit pasjetues, të fëmijëve ose në emër të kryefamiljarit të vdekur, kompensimi i akordohet per-

sonave përfitues të pensionit familjar", theksohet në projektvendimin e Këshillit Bashkiak. Në këtë të fundit bëhet me dije gjithashtu se pagesa që përfshihet në këtë vendim është kompensimi i energjisë elektrike për muajin gusht 2018 për kategoritë që rezultojnë përfituese, e kjo në të gjitha njësitet administrative të Bashkisë së Tiranës. Nëse vendimi do të miratohet, është detyra e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Sociale dhe Njësies Administrative të Bashkisë së Tiranës që të kujdesen për zbatimin e tij.

Përmbledhese e bordrosë se kompesimit te erezergjisë per ndihmen ekonomike per periudhen muaji Gusht 2018

| Nr | Njesia | NR | KOMPESIMI | NR | HEQJA E FASHE | TOTALI |
|----|--------------------|------------|----------------|------------|----------------|----------------|
| 1 | Njesia 1 | 1 | 640 | | - | 640 |
| 2 | Njesia 2 | 7 | 4,480 | 7 | 4,536 | 9,016 |
| 3 | Njesia 3 | 3 | 1,920 | 3 | 1,944 | 3,864 |
| 4 | Njesia 4 | 5 | 3,200 | 5 | 3,240 | 6,440 |
| 5 | Njesia 5 | 3 | 1,920 | 3 | 1,944 | 3,864 |
| 6 | Njesia 6 | 13 | 8,320 | 8 | 5,184 | 13,504 |
| 7 | Njesia 7 | 4 | 2,560 | 3 | 1,944 | 4,504 |
| 8 | Njesia 8 | 4 | 2,560 | 4 | 2,592 | 5,152 |
| 9 | Njesia 9 | 11 | 7,040 | 11 | 7,128 | 14,168 |
| 10 | Njesia 10 | | | | | - |
| 11 | Njesia 11 | 20 | 12,800 | 6 | 3,888 | 16,688 |
| 12 | Njesia Petrele | 9 | 5,760 | 9 | 5,832 | 11,592 |
| 13 | Njesia Farke | 20 | 12,800 | 20 | 12,960 | 25,760 |
| 14 | Njesia Zall-bastar | 108 | 69,120 | 11 | 7,128 | 76,248 |
| 15 | Njesia Berzhite | 68 | 43,520 | 68 | 44,064 | 87,584 |
| 16 | Njesia Krrabe | 16 | 10,240 | 16 | 10,368 | 20,608 |
| 17 | Njesia Baldushk | | | | | - |
| 18 | Njesia Shengjergj | | | | | - |
| 19 | Njesia Vaqarr | 19 | 12,160 | 19 | 12,312 | 24,472 |
| 20 | Njesia Kashar | 56 | 35,840 | 56 | 36,288 | 72,128 |
| 21 | Njesia Peze | 23 | 14,720 | 23 | 14,904 | 29,624 |
| 22 | Njesia Ndroq | 16 | 10,240 | 16 | 10,368 | 20,608 |
| 23 | Njesia Zall-herr | 38 | 24,320 | 33 | 21,384 | 45,704 |
| | TOTALI | 444 | 284,160 | 321 | 208,008 | 492,168 |

Konceptoi: Sp. Dh. Polovina

Pranoi: Përgj. F.Haxhi

Miratoi: Dr/DMPS: M.Kokeri

Përmbledhese e bordrosë se kompesimit te erezergjisë per ndihmen ekonomike per periudhen muaji Gusht 2018

| Nr | Njesia | NR | KOMPESIMI | NR | HEQJA E FASHE | TOTALI |
|----|--------------------|------------|----------------|------------|----------------|----------------|
| 1 | Njesia 1 | 1 | 640 | | - | 640 |
| 2 | Njesia 2 | 7 | 4,480 | 7 | 4,536 | 9,016 |
| 3 | Njesia 3 | 3 | 1,920 | 3 | 1,944 | 3,864 |
| 4 | Njesia 4 | 5 | 3,200 | 5 | 3,240 | 6,440 |
| 5 | Njesia 5 | 3 | 1,920 | 3 | 1,944 | 3,864 |
| 6 | Njesia 6 | 13 | 8,320 | 8 | 5,184 | 13,504 |
| 7 | Njesia 7 | 4 | 2,560 | 3 | 1,944 | 4,504 |
| 8 | Njesia 8 | 4 | 2,560 | 4 | 2,592 | 5,152 |
| 9 | Njesia 9 | 11 | 7,040 | 11 | 7,128 | 14,168 |
| 10 | Njesia 10 | | | | | - |
| 11 | Njesia 11 | 20 | 12,800 | 6 | 3,888 | 16,688 |
| 12 | Njesia Petrele | 9 | 5,760 | 9 | 5,832 | 11,592 |
| 13 | Njesia Farke | 20 | 12,800 | 20 | 12,960 | 25,760 |
| 14 | Njesia Zall-bastar | 108 | 69,120 | 11 | 7,128 | 76,248 |
| 15 | Njesia Berzhite | 68 | 43,520 | 68 | 44,064 | 87,584 |
| 16 | Njesia Krrabe | 16 | 10,240 | 16 | 10,368 | 20,608 |
| 17 | Njesia Baldushk | | | | | - |
| 18 | Njesia Shengjergj | | | | | - |
| 19 | Njesia Vaqarr | 19 | 12,160 | 19 | 12,312 | 24,472 |
| 20 | Njesia Kashar | 56 | 35,840 | 56 | 36,288 | 72,128 |
| 21 | Njesia Peze | 23 | 14,720 | 23 | 14,904 | 29,624 |
| 22 | Njesia Ndroq | 16 | 10,240 | 16 | 10,368 | 20,608 |
| 23 | Njesia Zall-herr | 38 | 24,320 | 33 | 21,384 | 45,704 |
| | TOTALI | 444 | 284,160 | 321 | 208,008 | 492,168 |

Konceptoi: Sp. Dh. Polovina

Pranoi: Përgj. F.Haxhi

Miratoi: Dr/DMPS: M.Kokeri



Projektvendimi/ Përfitojnë familjet në nevojë me 2-4 anëtarë

Programi i ndihmës ekonomike deri në 6%, propozohen 337 familje

Sa do të marrin personat me aftësi të kufizuar

Voltiza Duro

Në mbledhjen e Këshillit Bashkiak të Tiranës është propozuar edhe projektvendimi për miratimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe invalidët e punës për periudhën 1-30 shtator 2018. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot tabelat përmblidhëse të personave me aftësi të kufizuara që do të përfitojnë pagesa të mbrojtjes sociale për muajt shtator. "Në mbështetje të kësaj ligjori në fuqi përfitojnë

mbështetje financiare këto kategori: persona me aftësi të kufizuara, kujdestari i një personi me aftësi të kufizuara, persona të verbër, kujdestari i një personi të verbër, paraplegjik-tetraplegjik, kujdestari i një paraplegjik-tetraplegjiku, invalidë pune", - theksohet në relacion.

BLLOK-NDIHMJA EKONOMIKE

Në mbledhjen që do të mbahet pas 2 ditësh, pritet gjithashtu miratimi i projektvendimit "Për miratimin e familjeve aplikuese që përfitojnë nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6%, nga fondi i kushtëzuar dhe nga buxheti i Bashkisë

Tiranë, për periudhën 1-31 gusht 2018". Sipas relacionit të Këshillit Bashkiak të Tiranës, pranë Drejtorisë së Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale janë depozituar në total 337 dosje, e nga këto 122 do të trajtohen me fondet e buxhetit vendor, ndërsa 215 prej tyre nga fondi i kushtëzuar 6%. "Struktura përgjegjëse propozon që të trajtohen familjet që kanë në përbërje të tyre: familje me shumë se 4 anëtarë në nevojë, familje me një anëtar në nevojë, familje nga 2-4 anëtarë në nevojë, familje rome dhe egiptiane, vajza në nevojë, gratë kryefamiljare të divorcuara/ të

veja me fëmijë në ngarkim, familje me 2 anëtarë në vështrim për t'u pranuar në tregun e punës", - theksohet në relacion. "Si rrjedhojë, nga familjet aplikuese, Drejtoria e Mbrojtjes Sociale ka vlerësuar sipas sistemit të pikëzimit të aplikantëve për çdo njësi administrative dhe ka hartuar tabelën përmblidhëse të aplikantëve për çdo njësi administrative dhe bazuar në to propozon listën totale të çdo familjeje të mundshme përfituese nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% dhe me fondet e buxhetit vendor, si dhe masën e ndihmës në lekë për çdo familje", - thuhet në vendim.

| Nr. | Njesite Administrative | LLOJI I PAK | | | | | | | | | | | | | | | | TOTALI | |
|-----|------------------------|-------------|------------|-------------------------|-----------|------------------|------------|---------------------|------------|--------------------------|------------|---------------------------|-----------|--------------|------------|--------|-------------|--------|--|
| | | TE VERBER | | KUJDESTAR PER TE VERBER | | PAK FIZIK MENDOR | | KUJDESTAR PAK FIZIK | | PARAPLEGJIK TETRAPLEGJIK | | KUJDESTAR PARATEPAPLEGJIK | | INVALID PUNE | | Nr. | Fondi | | |
| | | Nr. | Fondi | Nr. | Fondi | Nr. | Fondi | Nr. | Fondi | Nr. | Fondi | Nr. | Fondi | Nr. | Fondi | | | | |
| 1 | Nr. 1 | 115 | 1.587.115 | 34 | 398.820 | 364 | 3.785.880 | 82 | 841.895 | 38 | 1.075.244 | 37 | 401.450 | 921 | 2.844.400 | 1.591 | 10.934.804 | | |
| 2 | Nr. 2 | 139 | 1.881.250 | 34 | 398.820 | 401 | 4.196.478 | 108 | 1.120.805 | 73 | 2.102.026 | 73 | 792.050 | 1.227 | 3.865.500 | 2.055 | 14.356.929 | | |
| 3 | Nr. 3 | 108 | 1.462.170 | 33 | 410.550 | 263 | 2.758.110 | 69 | 702.440 | 60 | 1.707.368 | 60 | 645.575 | 968 | 3.046.000 | 1.561 | 10.732.213 | | |
| 4 | Nr. 4 | 145 | 1.939.485 | 28 | 351.900 | 534 | 5.606.534 | 110 | 1.234.435 | 70 | 2.019.568 | 65 | 726.430 | 1.186 | 3.890.800 | 2.138 | 15.769.152 | | |
| 5 | Nr. 5 | 163 | 2.158.074 | 54 | 645.150 | 410 | 4.332.108 | 135 | 1.415.210 | 60 | 1.819.422 | 57 | 743.225 | 1.248 | 3.935.000 | 2.127 | 15.048.189 | | |
| 6 | Nr. 6 | 171 | 2.302.076 | 50 | 586.500 | 585 | 6.028.188 | 140 | 1.457.814 | 79 | 2.169.070 | 79 | 851.724 | 1.154 | 3.691.900 | 2.258 | 17.087.272 | | |
| 7 | Nr. 7 | 132 | 1.819.779 | 44 | 516.120 | 369 | 3.913.058 | 111 | 1.161.725 | 65 | 1.824.370 | 65 | 710.675 | 1.141 | 3.593.700 | 1.927 | 13.539.427 | | |
| 0 | Nr. 8 | 102 | 1.402.334 | 24 | 281.520 | 269 | 3.176.382 | 86 | 887.480 | 40 | 1.128.212 | 40 | 434.000 | 818 | 2.557.700 | 1.379 | 9.867.628 | | |
| 9 | Nr. 9 | 121 | 1.616.081 | 28 | 328.440 | 368 | 3.851.776 | 96 | 1.012.340 | 55 | 1.534.820 | 54 | 585.900 | 975 | 3.095.400 | 1.697 | 12.024.757 | | |
| 10 | Nr. 10 | 53 | 723.458 | 15 | 175.950 | 122 | 1.286.072 | 41 | 413.200 | 23 | 663.606 | 23 | 238.700 | 493 | 1.511.500 | 770 | 5.012.486 | | |
| 11 | Nr. 11 | 104 | 1.384.912 | 31 | 363.630 | 491 | 5.206.278 | 109 | 1.156.960 | 72 | 2.150.978 | 72 | 835.450 | 974 | 3.168.800 | 1.853 | 14.267.008 | | |
| 12 | Petrole | 15 | 187.990 | 4 | 46.920 | 68 | 702.440 | 10 | 103.300 | 23 | 661.198 | 22 | 244.125 | 69 | 224.900 | 211 | 2.170.873 | | |
| 13 | Farke | 34 | 462.077 | 11 | 129.030 | 114 | 1.179.564 | 27 | 278.910 | 20 | 555.728 | 20 | 217.000 | 173 | 566.600 | 399 | 3.388.909 | | |
| 14 | Dajt | 43 | 597.911 | 13 | 152.490 | 156 | 1.787.090 | 44 | 475.180 | 32 | 911.426 | 32 | 358.500 | 237 | 757.900 | 557 | 5.040.477 | | |
| 15 | Zall-Bastar | 24 | 304.594 | 3 | 35.190 | 130 | 1.394.550 | 16 | 165.280 | 14 | 434.400 | 14 | 173.600 | 65 | 233.200 | 266 | 2.740.814 | | |
| 16 | Berzhite | 20 | 311.702 | 8 | 93.840 | 75 | 778.614 | 12 | 123.960 | 8 | 221.232 | 8 | 86.800 | 71 | 210.600 | 202 | 1.826.748 | | |
| 17 | Krrabe | 6 | 79.172 | 1 | 11.730 | 44 | 455.168 | 9 | 98.135 | 3 | 84.286 | 3 | 32.550 | 48 | 152.300 | 114 | 913.341 | | |
| 18 | Baldushk | 32 | 441.490 | 15 | 187.680 | 79 | 919.370 | 11 | 162.750 | 1 | 28.330 | 1 | 10.850 | 46 | 176.700 | 185 | 1.927.170 | | |
| 19 | Shengjergj | 6 | 77.780 | 3 | 35.190 | 39 | 413.200 | 12 | 123.960 | 4 | 105.320 | 4 | 51.400 | 32 | 103.400 | 100 | 910.250 | | |
| 20 | Vaqarr | 24 | 344.244 | 4 | 46.920 | 106 | 1.151.782 | 22 | 227.260 | 10 | 492.626 | 10 | 184.450 | 99 | 330.000 | 275 | 2.777.282 | | |
| 21 | Kashar | 80 | 1.143.592 | 25 | 293.250 | 270 | 2.996.988 | 85 | 872.885 | 39 | 1.117.958 | 38 | 412.300 | 449 | 1.435.100 | 986 | 8.272.073 | | |
| 22 | Peze | 26 | 350.492 | 14 | 164.220 | 57 | 595.250 | 9 | 92.970 | 7 | 202.846 | 7 | 75.950 | 62 | 221.000 | 182 | 1.702.728 | | |
| 23 | Ndroq | 27 | 382.144 | 13 | 152.490 | 82 | 853.500 | 20 | 206.600 | 11 | 292.166 | 11 | 119.350 | 78 | 254.000 | 242 | 2.260.250 | | |
| 24 | Zall-Herr | 25 | 319.698 | 12 | 140.760 | 118 | 1.220.220 | 30 | 309.900 | 19 | 524.270 | 19 | 206.150 | 122 | 384.400 | 345 | 3.105.398 | | |
| | TOTALI | 1.715 | 23.279.620 | 501 | 5.947.110 | 5.514 | 58.588.600 | 1.394 | 14.645.394 | 826 | 23.826.470 | 814 | 9.137.754 | 12.656 | 40.250.800 | 23.420 | 175.675.748 | | |

Kreu i Kuvendit: Ëndërroj që Presheva, Medvegja e Bujanovci t'i bashkohen Kosovës

Kadri Veseli: Kundër cenimit të territorit të Serbisë

Ngërçi politik, kreu i PDK-së kundër Thaçit

Për t'u arritur fitorja ndaj Serbisë me anën e një marrëveshjeje përfundimtare si dhe për t'u bërë ballafaqimi me të duhet të bashkohet spektri politik i Kosovës. E për të arritur një bashkim të forcave mes partive politike, kryetari i Kuvendit dhe i PDK-së, Kadri Veseli, thotë se është duke punuar. Ai thekson se do të mundohet që t'i ulë të gjithë liderët në një tryezë sikurse kishte bërë për demarkacionin, në mënyrë që të arrihet konsensusi për procesin e dialogut. Veseli ka ritheksuar edhe një herë qëndrimin se Kosova është unike dhe nuk do të ketë cenim të integritetit territorial. Por thotë se ëndërron që Presheva, Medvegja e Bujanovci t'i bashkohen Kosovën dhe nuk do të ndalet së punuari për ta, edhe pse është kundër cenimit të integritetit territorial të Serbisë. Kreu i Kuvendit fton të gjithë spektrin politik që të jenë bashkë në ballafaqimin final në dialogun me Serbinë tash kur qeveria ka formuar një ekip negociator, por që ende nuk ka marr miratimin e Kuvendit. Në lidhje për këtë konsensus, Veseli thotë se do të mundohet që të ulë të gjithë në një tryezë ashtu siç ka bërë për çështjen e demarkacionit me Malin e Zi, për të cilën thotë se kanë humbur tri vjet dhe ende po flasin për temën e cila tashmë do duhej të ishte e kryer qysh moti. Veseli thotë se një pjesë e madhe e opozitës e kuptojnë faktin se duke hapur betejën me pozitën, goftë edhe me idenë e marrjes së pushtetit, për ta dëmtuar para qytetarëve, nuk fiton Kosova. Këtë siç e quan ai "ta mundim Serbinë" Veseli e sqaron se vetëm së bashku mund ta vendim Serbinë në faktin e pretendimeve të tyre për destabilizimin e regjionit, për nxitjen e konflikteve. Madje me këtë rast Veseli përmend edhe fjalimin e presidentit serb Aleksandar Vuçiç gjatë qëndrimit në Kosovë e që i quan "promovim i politikave, të cilat kanë qenë gjenocidale". Në lidhje me lejimin e presidentit serb në Kosovë e që foli në superlativ për Sllobodan Millosheviçin, Veseli thotë se vendimarrja është në partneritet me partnerët ndërkombëtarë dhe me këtë tregon se Kosova e pavarur nuk është precedent i destabilizimit, nuk është precedent i luftës, është precedent i paqes dhe i stabilitetit. Veseli thotë se tema për ndarje, e cila së fundmi po diskutohet edhe në Kuvendin e Kosovës është e rrezikshme dhe e dëmshme. Veseli ka përsëritur se Kosova është një e pavarur dhe sovranë duke shtuar se nuk do të lejojnë asnjë pushtet paralel në Kosovë, ndërsa nuk është



Presidenti i Serbisë bojkoton Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së

Aleksandar Vuçiç, presidenti i Serbisë ka vendosur që të fillojë një fazë të re në raportet me bashkësinë ndërkombëtare, që mund të quhet edhe si bojkotim i heshtur i Brukselit dhe Uashingtonit. Vendimin e ka marrë Vuçiç, por e ka publikuar udhëheqësi i zyrës për Kosovë Marko Gjuriç, i cili tha se Brukseli duhet të presë pak për vizitën e ardhshme të Vuçiçit atje. Ndërkohë që Vuçiç nuk do të marrë pjesë as në Asamblenë e Përgjithshme të OKB. Në Nju Jork do të udhëtojë kryeministria Ana Brnabiç. Gjuriç shpjegoi se Vuçiç ka ofruar disa zgjidhje për çështjen e Kosovës, por atë e kanë kritikuar shumë për këto ide. Gjuriç tha se presidenti i Serbisë është përballur me heshtje, me distancim nga idetë e tij, e madje edhe "me sulme të tmerrshme", ndaj Gjuriç tha se në Bruksel "tani do të presin edhe ca kohë deri sa Vuçiç të shkojë në takimin e ardhshëm".

mbëtarë dhe me këtë tregon se Kosova e pavarur nuk është precedent i destabilizimit, nuk është precedent i luftës, është precedent i paqes dhe i

stabilitetit. Veseli thotë se tema për ndarje, e cila së fundmi po diskutohet edhe në Kuvendin e Kosovës është e rrezikshme dhe e dëmshme. Veseli

ka përsëritur se Kosova është një e pavarur dhe sovranë duke shtuar se nuk do të lejojnë asnjë pushtet paralel në Kosovë, ndërsa nuk është

përgjigjur drejtpërdrejt nëse është kundër presidentit Hashim Thaçi duke lënë të kuptohet se nuk përkrah korrigjimin e kufijve. Në këtë intervistë Veseli ka folur edhe për të drejtat e shqiptarëve në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanovc të cilat sipas tij nuk respektohen nga ana e shtetit të Serbisë. Ai thotë se Kosova gjithnjë do të përkushtohet për popullatën e kësaj pjese që gjendet në territorin e Serbisë, por nuk do t'i japin asnjë mundësi precedentit përmes së cilit Serbia mund të pretendojë se po cenohet sovraniteti i tyre. Ai në këtë intervistë ka folur edhe për liberalizimin e vizave për Kosovën e që beson se do të ndodhë brenda këtij viti. Ai premon se institucionet do të punojnë intensivisht që ta kenë rezultatin pozitiv për viza ndërkohë që nuk mendon se të rinjtë do ta lëshojnë Kosovën në rast të liberalizimit. Veseli shpreson se në fund të vitit do të ketë vendimarrje pozitive ndërsa thotë se qytetarët e Kosovës e meritojnë që mos të jenë të izoluar.

Eksperti amerikan: "Korrigjimi i kufijve", Berlioni s'është pengesa

Vijon të jetë problema tike ideja për shkëmbim të territorit ose ndryshim të kufijve, si edhe propozim ofendues, mirëpo nëse kjo ide merr mbështetjen e të gjithëve në Kosovë dhe Serbi, rajonit mund t'i sjellë finalizimin e kufijve pas rënies së Jugosllavisë, thotë eksperti i Këshillit për Marrëdhënie me Jashtë të SHBA-së, Charles Kupchan. Së fundi, Kupchan ka thënë për New York Times se Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara duhet të mbështesin këtë ide. Ndërkaq në një intervistë



për Radio 'Evropa e Lirë', shpjegon argumentet e kësaj mbështetjeje, për siç ka thënë "në thelb është një formë paqësore e spastrimit etnik", dhe pse sipas tij presidentët Hashim Thaçi dhe Aleksandar Vuçiç duhet të fitojnë konsensusin për këtë ide në vendet e

tyre pasi, sipas Kupchan, kundërshtimi i Berlinit nuk është shumë domethënës. Kupchan është i bindur se një Serbi e kënaqur, në të ardhmen do të ishte një pengesë e aspiratave të Milorad Dodikut për pavarësi të Republikës Serbe. Kupchan flet edhe për sesi është e mundur t'i mbyllet dera ndikimit rus në Ballkan dhe pse është gabim ta shikojmë marrëveshjen Kosovë-Serbi si një konspiracion nga "kuzhina" e presidentit rus Vladimir Putin dhe liderit të së djathtës së re Stephen Bannon.

PRESHEVA KUNDËR KORRIGJIMIT TË KUFIJVE

Në Luginën e Preshevës, as shqiptarët dhe as serbët nuk i kushtojnë shumë vëmendje dhe nuk flasin për ndryshimin e kufirit mes Kosovës dhe Serbisë. Kështu shkruan AFP, e cila citohet edhe nga media tjera ndërkombëtare. Ata janë të zënë, në përpjekje për ta përballuar jetën mes vështirësive, shkruan më tej gazeta.

HOTI: DIALOGUN TA UDHËHEQË NJË QEVERI E FUQISHME

Shefi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Avdullah Hoti thotë se qeveria e Kosovës s'mund ta udhëheqë dialogun, e as ta delegojë këtë autoritet të dikush tjetër, pasi sipas tij, Kosova ka qeveri të pakicës. Hoti thotë se dialogu mes Kosovës dhe Serbisë në Bruksel, që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian, duhet të udhëhiqet nga një qeveri e fuqishme "me bazë të gjerë".

"Le Monde" publikon "hartën" e shkëmbimit të territoreve

Ditën e djeshme gaze ta franceze "Le Monde" ka botuar dy tekste për shkëmbimin e mundshëm të territorit midis Beogradit dhe Prishtinës, si dhe hartën e Kosovës me interpretimin e saj në mënyrë që të duket si "ndryshim i kufijve". Në tekstin e parë, gazeta shkruan se "shkëmbimi i territoreve bazuar në kritere kretjesisht etnike është shqetësues", dhe se "etika dhe pragmatizmi janë në konflikt me njëri-tjetrin në debatin për një ndryshim të mundshëm në kufijtë midis të dy palëve", shkruan "KosovaPress".

STUHIA "FABIENNE" GODET EUROPËN, VIKTIMA E PARË NË GJERMANI

Stuhia e fuqishme "Fabienne" ka goditur orët e fundit Europën Veriore dhe Qendrore. Viktima e parë është shënuar në Gjermani. Një grua humbi jetën në Bavari, pasi erërat e forta thyen pemë e shkatërruan një zonë kampingu. Mediat gjermane flasin po ashtu për disa të plagosur. Erërat e forta arritën një shpejtësi mbi 100 km/orë, duke sjellë me vete reshje të dendura shiu, përmbytje, dhjetëra aksidente rrugore, banesa të dëmtuara, etj.



MË NË FUND PUBLIKOHET KËNGA E NOIZYT ME REPERIN ITALIAN GHALI

SUMMER

pages

SUPLEMENT I GAZETIA SHQIPTARE

E martë 25 Shtator 2018




'Të pasme të mëdha, zemër e madhe',
Fjolla po çmend fansat me foto provokuese



Françeska nuk di të përmbahet,
ekspozon gjoksin pa të brendshme

BULEVARDI
POLITIK



- Basha përcjell Mesilën, ia shtron me Monikën dhe analistët
- Çfarë nuk u pa në parlament, Rama i gëzuar me Xhafajn, deputeti i "fut" krahun Tom Doshit
- Rakia bën bashkë deputetët e PS dhe LSI, ia marrin me këngë e valle
- Deputeti i PS-së shkon në parlament me zinxhir zbërthyer



"Politika? Një zanat si gjithë të tjerët"

POROSIA E MODERATORIT PËR DJALIN:

Jeta s'është bardhë e zi, por me ngjyra

"Dilema" e Arian Çanit: A mos jemi thjesht ëndrra e një qeni?

“Politika? Një zanat si gjithë të tjerët”

Porosia e moderatorit për djalin:

Jeta s'është bardhë e zi, por me ngjyra

"Dilema" e Arian Çanit: A mos jemi thjesht ëndrra e një qeni?

Egla Xhemali

A i është një "cunam" i vërtetë, një nga moderatorët më të dashur për publikun. Arian Çani mban trofeun e së premtës për emisionin më të ndjekur ndër vite. Personazhe dhe karaktere njafte interesante, trajtesa ndryshe të temave, duke filluar që nga ato të politikës, për të vazhduar te lajmet rozë. Gjithçka merr një dimension tjetër tek "Zonë e lirë". Ariani nuk lodhet kurrë së qenuri vëtoetja. Një shpirt i lirë, pa komplekse që vjen në rrefimin për "Gazeta shqiptare", për të ndarë me ne disa të fshehta, që jo çdokush i di. Këtë herë duke lënë larg petkun e moderatorit të suksesshëm, Çani na tregon se si është të heqësh dorë nga jeta e natës, pse ka folur së fundmi me veten, porosinë më të madhe që i ka dhënë të birit, për pasionin që ka për vrapin dhe politikën. Ai e sheh botën me plot ngjyra e këtë ua përcjell fëmijëve të tij. Gjithmonë vajzën e ka cilësuar si pikë të dobët. I pyetur se si e mendon çastin kur ajo do jetë para altarit, Çani parapëlqen të mos e mendojë fare. Më tej, ai na thotë se nuk do heqë asnjëherë dorë nga vrapin. Sa i përket politikës, moderatori pohon se e sheh si gjithë zanatet e tjerë.



Si është të heqësh dorë nga jeta e natës?
"Cool".
Kompleksi më i fortë që ke mundur ta kapërcesh?
S'kam pasur komplekse.
Mendimi që ke për meshkujt posesivë?
Budallenj.
Për çfarë ke folur së fundmi me veten?
A mos jemi thjesht ëndrra e një qeni?
Si e mendon çastin kur vajza jote do jetë para altarit?
S'e mendoj fare.
Porosia më e madhe që i ke dhënë tët birit?

Që jeta nuk është bardhë e zi, por është me ngjyra.
Kur mbaron për ty një raport në çift?
Kur njëri ikën.
Ka diçka që nuk ka ndryshuar te gruaja jote, që nga çasti i parë që e ke njohur?
Vështrimi i saj.
Mendon se do heqësh dorë ndonjëherë nga vrapin?
Asnjëherë.
Me çfarë do e krahasoje politikën në Shqipëri?
Zanat si gjithë të tjerët.



Të pasme të mëdha, zemër e madhe', Fjolla po çmend fansat me foto provokuese

Këngëtarja Fjolla Morina i është përveshur punës që së shpejti të sjellë këngën e saj më të re. Ajo ka publikuar për fansat e saj në rrjetin social 'Instagram' një fotografi, ku shfaqet në studio, duke treguar kështu se është duke incizuar projektin e saj më të ri muzikor. Këngëtarja, e cila shquhet për linjat trupore, ka pozuar tejet seksi duke kthyer në qendër të pasmet tërheqëse, ndërsa ka shkruar në mbishkrimin e fotografisë "Të pasme të mëdha, zemër e madhe".



Françeska nuk di të përmbahet, ekspozon gjoksin pa të brendshme

Modelja seksi Françeska Jaçe nuk i ndal asnjëherë fotot provokuese. Këtë herë ajo ka publikuar një foto në rrjete sociale, ku shfaqet me një bluzë mjaft transparente dhe poshtë saj i dallohet gjoksi pa recipeta. Nuk është hera e parë që Françeska publikon postime të tilla ku shfaqet joshëse dhe tejet provokuese. Ish-banorja e 'Big Brother' është shquar gjithnjë për format e saj shpërthyes.



Kë quan mbretëreshë të muzikës Tayna?

Reperja Tayna ishte pa dyshim është një nga këngëtares më të dashura për publikun. Së fundmi, ajo ka publikuar në 'Instagram' një fotografi ku shfaqej mjaft tërheqëse e veshur me një bluzë të bardhë dhe të gjatë. Në këtë bluzë, ajo kishte të stampuar portretin e të madhes Nexhmije Pagarusha, këngëtarja e cila është pagëzuar me epitetin "Bilbili i Kosovës". "Zbuloni legjendën, mbretëreshën Nexhmije", ka shkruar reperja në mbishkrimin e fotografisë. Mesa duket, si shumë artistë të tjerë shqiptarë, edhe për Taynën, legjenda e muzikës, Nexhmije Pagarusha, ka shërbyer si inspirim për të.



Më në fund publikohet kënga e Noizyt me reperin italian Ghali

Kënga, e cila u paralajmërua gjatë gjithë verës, më në fund u publikua dhe tashmë gjendet në Youtube. Behet fjalë për 'Parku i lojërave' të Noizyt në bashkëpunim me reperin e njohur italian Ghali. Ky projekt do publikohet më parë mirepo u shty për shkaqe të panjohura. Si të gjitha këngët e reperit pritet që dhe kjo këngë të jetë e suksesshme e të shndërrohet në hit. Kujtojmë se Noizy së shpejti sjell këngë me Dafina Zeqirin bashkëpunimi i parë mes dy artistëve, të cilët dikur nuk flisnin me njëri-tjetrin.



Basha përcjell Mesilën, ia shtron me Monikën dhe analistët

Kreu i PD Lulzim Basha pasi prezantoi platformën kundër korrupsionit dhe oligarkisë, ka mbledhur aleatën e tij të LSI Monika Kryemadhin dhe ish-deputetën e PDIU Mesila Doda, e cila së fundmi i është bashkuar PD-së, në një bar-restaurant në kryeqytet. Mesila, siç duket edhe në këtë foto të publikuar nga newsbomb.al, nuk ka ndenjur gjatë në tavolinë dhe është larguar duke u takuar përzemërsisht me Bashën. Ndërkohë në tryezë me liderët e opozitës, mes të cilëve spikat edhe juristi Çlirim Gjata, janë analistët e njohur. Nuk dihet pse kjo "mbledhje" e Bashës me analistët dhe emrat e njohur të gazetarisë, por synimi i kreut të PD është "turbullimi njëherë e mirë i ujërave" dhe rrëzimi nga pushteti i Ramës.



Çfarë nuk u pa në parlament, Rama i gëzuar me Xhafajn, deputeti i "fut" krahun Tom Doshit

Aksioni "Oaz" duket se ka sjellë qetësinë edhe mes deputetëve të mazhorancës. Arrestimi i të fortëve të Shkodrës është përsëritur nga zv.kryeministrja, Senida Mesi, kjo e fundit paralajmëroi se "nuk do të këtë asnjë kompromis, por do të goditen bandat e tjera". Edhe në seancën e sotme ku nuk mori pjesë opozita, socialistët janë shfaqur më në humor se në seancën e kaluar. Më të relaksuara dukeshin dhe marrëdhëniet mes kryeministrit Edi Rama dhe Fatmir Xhafaj, të cilët janë fotografuar duke biseduar me njëri-tjetrin, duke komunikuar dhe me gjeste. Po ashtu në një fotot tjetër, Xhafaj është shfaqur i gëzuar dhe gjatë komunikimit me kolegët ministra. Ndërsa që në këtë seancë ra në sy rikthimi Pandeli Majkos, i cili bojkotoi për të dytën herë votimin e prishjes së Teatrit Kombëtar. Ndërkohë që një tjetër foto që ka shprehur LSA ishte ajo e deputetit të Shkodrës, Tom Doshit i rrethuar nga socialistët.



BULEVARDI POLITIK

Në merrni seriozisht! 😊

Rakia bën bashkë deputetët e PS dhe LSI, ia marrin me këngë e valle

Ka qenë panairi "Skraparit në gotën e rakisë" ai që ka mbledhur bashkë në Bogovë shumë banorë të zonës, të cilët kanë festuar për këtë produkt që i identifikon ata në gjithë vendin. Pjesë e kësaj feste lokale janë bërë edhe deputeti i Partisë Socialiste, Fidel Ylli dhe ai i Lëvizjes Socialiste për Integritim, Nasp Naço. Siç shihet edhe nga fotot të dy deputetët, nën shoqërinë edhe të kryetarit të Bashkisë së Skraparit, duken të qeshur me gotën e rakisë përpara, ndërsa gjatë këtij aktiviteti nuk kanë nguruar t'ia marrin këngës edhe valles.



Deputeti i PS-së shkon në parlament me zinxhir zberthyer

Ai është një nga deputetët e parlamentit shqiptar me stil mjaft të veçantë, por këtë herë është treguar paksa i shkujdesur. Deputeti socialist Fate Velaj, është shfaqur pranë ambienteve të parlamentit me zinxhirin e pantallonave të zberthyer. Fate Velaj u paraqit në seancë me pantallona të bardha, të cilat i kishte kombinuar me një kapele republikane ngjyrë të bardhë, gjithashtu. Gjithçka ishte ok, nëse nuk do të kishte harruar të mbyllte zinxhirin e pantallonave!



SHKURT



Tritol shtyllës elektrike, kapet 20-vjeçari

KUKËS - Një shpërthim me tritol ka ndodhur në orët e vona të mbrëmjes së të dielës në Kalimash të Kukësit. Mësohet se një shtyllë elektrike që furnizonte me energji ish-fabrikën e kromit i është vendosur lëndë plasëse. Mësohet se shpërthimi ka ndodhur në orën 23:30 tek vendi i quajtur "Boka e Kalimashit". Ndërkohë, lidhur me ngjarjen policia ka arrestuar si autor të dyshuar 20-vjeçarin Feim Lugja, banues në fshatin Kalimash. Në vendin e ngjarjes u gjet dhe u sekuestrua në cilësinë e provës materiale 6 m fitil zjarr-përcjellës, i ngjashëm me atë që u gjet në banesën e tij. Mbi të riun rëndojnë akuzat: "Shkatërimi i pronës me eksploziv" dhe "Prodhimi, mbajtja pa leje e lëndëve plasëse" dhe "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve".

Vidhet në mes të ditës shtëpia e biznesmenit

KORÇË - Banesa e një biznesmeni në Korçë është bastisur në mes të ditës. Vjedhja është regjistruar paraditen e djeshme në shtëpinë e biznesmenit Niko Koço. Mësohet në momentin e ngjarjes në banesën, e cila ndodhet në lagjen nr.4 të qytetit juglindor, nuk ka pasur njeri. Në vendngjarje kanë mbërritur forcat e policisë, të cilët nisën hetimet për zbardhjen e ngjarjes. Ndërkaq, burime nga blutë bënë me dije se autorët (ende të paidentifikuar kanë mundur të marrin disa bizhuteri me vlerë.



TIRANË - Arrin në 5 numri i personave të arrestuar për mashtrim me TVSH-në. Në vijim të operacionit që nisi pak ditë më parë, policia e Tiranës ka vënë në pranga një 36-vjeçar, një ndër 6 personat e shpallur në kërkim për shtetasin Elton Zoto, banues në kryeqytet. Sipas bluve, 36-vjeçari në bashkëpunim me shtetasit: Gëzim Cela, Flamur Zoto, Xhemal Kushova, Ylber Molla (të arrestuar më datë 21.09.2018 në

Policia: I shkaktuan 3 miliardë lekë dëm shtetit

Skemë mashtrimi me TVSH-në, përfundon në pranga i 5-ti, në kërkim edhe 5 të tjerë

kuadër të operacionit të koduar "TVSH", kishin krijuar një skemë mashtrimi duke krijuar 6 firma fiktive me nipte shëtitës, me seli në qytetin e Tiranës, me qëllim shmangien e pagesave të TVSH dhe tatimitimit, duke i shkaktuar shtetit

dëm në vlerë TVSH-je dhe tatimitimit në vlerën e 350 milionë lekë të reja. Po të njëjtat burime thanë se vijon puna për kapjen e pesë shtetasve të tjerë të shpallur në kërkim. Materialet procedurale ju kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së

Parë Tiranë në ngarkim të shtetasit E.Z., për veprat penale të "Fshehje të ardhurash", "Mospagimi i taksave dhe tativeve", "Krijimi i skemave mashtruese lidhur me tatimin mbi vlerën e shtuar" dhe "Falsifikimi i vulvave stampave dhe formularëve".

Aktivistët: Banorët do ndërhyjnë me dhunë, s'kemi më rrugë ligjore për të vepruar"

Apeli rrëzon kërkesën për ndalimin e ndërtimit të 3 HEC-ve në Tropojë

"Ankimimi i përmbaruesit u depozitua me vonesë"

SHKODER

Gjykata e Apelit në Shkodër nuk ka pranuar ankimimin e bërë për ndalimin e punimeve për ndërtimin e tre hidrocentraleve në lumin Valbona në Tropojë. Trupi gjyqësor, në vendimin e tij bëri me dije se ankimuesi që është përmbaruesi, Eduart Mrishaj ka shkelur afatet ligjor duke mos e depozituar në kohë ankimimin e tij. Aktivistët dhe banorët e Tropojës që janë kundër ndërtimit të hidrocentraleve në Valbonë deklaruan se tashmë do ndërhyjnë me dhunë për t'i ndaluar punimet sepse nuk ka më rrugë ligjore. "Ne nuk jemi aspak të kënaqur, pasi të kënaqur do të jemi vetëm kur të ndalen punimet në lumin e Valbonës dhe të kthehet në gjendjen e mëparshme. Gjyqtari nuk u mor me çështjen konkretisht, por me procedurën dhe procedura është që punonjësi i shtetit që është përmbaruesi i Bajram Currit, i cili nuk i kishte respektuar afatet për depozitimin e ankimimit dhe nuk kishte dhënë asnjë arsye për këtë vonesë të tij. Kam një thirrje për Ministrinë e Drejtësisë, e cila reagoi dhe tha se jemi kundër asaj që po ndodh në Valbonë, ndërkohë që përmbaruesi Eduart Mrishaj i shkeli këto rregulla. Kam apel edhe për kryeministrin Rama, i cili bashkë me ministrin Blendi Klosi ndërhyri dhe ndërpreu atë që ndodhte në Osum. Kjo do të zgjidhet në mënyrë civile ose politike dhe banorët do shkojnë për të ndërhyrë me dhunë, sepse nuk kemi më rrugë ligjore për të vepruar", u shpreh Mirjan Allaj, aktivist kundër ndërtimit të hidrocentraleve në Tropojë. Një shpresë për ndalimin e punimeve në hidrocentralet në Valbonë është tek procesi i vetingut nga amerikana Katerina Bone, e cila, gjithashtu, është një aktiviste që kërkon ndaljen e punimeve për ngritjen e hidrocentraleve në Valbonë. Aktivistët dhe banorët e Tropojës dys-



hojnë se tashmë koncesionari ka aplikuar edhe për ndërtimin e hidrocentraleve të tjerë në këtë lum dhe në rast se miratohet ajo kërkesë, atëherë për lumin në fjalë do të ishte, sipas aktivistëve, një katastrofë dhe shkatërrim i lumit Valbona.

REAGIMI I AKTIVISTË VE

"Kam një thirrje për Ministrinë e Drejtësisë, e cila reagoi dhe tha se jemi kundër asaj që po ndodh në Valbonë, ndërkohë që përmbaruesi Eduart Mrishaj i shkeli këto rregulla. Kam apel edhe për kryeministrin Rama, i cili bashkë me ministrin Blendi Klosi ndërhyri dhe ndërpreu atë që ndodhte në Osum. Kjo do të zgjidhet në mënyrë civile ose politike dhe banorët do shkojnë për të ndërhyrë me dhunë, sepse nuk kemi më rrugë ligjore për të vepruar", u shpreh Mirjan Allaj, aktivist kundër ndërtimit të hidrocentraleve në Tropojë

TIRANË - Ndërsa në emisionin "Me zemër të hapur" në "New s24" diskutohet çështja e abuzimit të një 11-vjeçareje nga mësuesi i saj, i cili tashmë është në liri, një denoncim tjetër i rëndë ka ardhur live. Një prind nga Gjirokastra që e njihte mësuesin 63-vjeçar, Myzo Dida, e akuzoi në një lidhje telefonike se ka abuzuar me një tjetër ish-nxënëse të tij që aktualisht është maxhorore dhe ndodhet në Vlorë. "Fias nga Gjirokastra, jam fqinj me atë familjen. Ai mësues i ka dhënë mësim dhe djali tim. Im bir më ka treguar për një vajzë tjetër që sot është e martuar dhe ndodhet në Vlorë. Dhe ajo është abuzuar. Nxirreni këtë çështje.

Abuzoi me të miturën në Tepelenë, një tjetër denoncim për mësuesin



Mund të hulumtoni. Ai maskarai ka abuzuar me të", tha prindi gjatë lidhjes live. Familja Muçodemi që po kalon traumën e abuzimit të vajzës 11-vjeçare ishte dje në studion e emisionit "Me zemër të hapur" në "New s24" për të kërkuar ndihmë, pasi

vajza e tyre është mbyllur brenda që kur gjykata ka nxjerrë nga burgu mësuesin. Ajo nuk pranon të kthehet as në shkollë më. Për më tepër nëna e vajzës ka treguar se po kërcënohen, pasi jashtë shtëpisë së tyre është qëlluar me armë.

Dajë e nip humbin jetën nga asfiksia teksa po pastronin pusin

LEZHË - Tragjedi në Lezhë. Dy persona humbën jetën pasditën e djeshme në fshatin Torovicë teksa ishin duke punuar për pastrimin e një pusi. Bë het fjalë për 35-vjeçarin Martin Gjonaj nga Puka dhe 21-vjeçarin Marjan Ndoci, të cilët sipas burimeve nga policia lokale janë rrëzuar dhe kanë rënë brenda në pus. Menjëherë banorët të zonë s kanë ndërhyrë për t'i nxjerrë, por ka qenë e pamundur. Sipas dëshmitë banorë ve, zjarrfikësja është vonuar rreth një orë për të shkuar në vendngjarje, çka ka rezultuar fatale për dajë e nip, të cilët janë asfiksuar. Ndërkaq, në fshatin Torovicë ka shkuar dhe policia, e cila po heton për zbardhjen e plotë të rrethanave të kësaj ngjarjeje.



BOTIMI

Autori do t'i dhurojë të gjitha të ardhurat nga shitja e librit të tij në UNHCR, pasi mendon që u kemi borxh mijëra njerëzve që humbën jetën në det

KHALED HOSSEINI

Lutje detit, letra e shkrimtarit për refugjatët e Alan Kurdin

Libri "Lutje detit" është një libër për të gjitha moshat, një histori për të rriturit, për prindërit, për ata që përpiqen të gjejnë një vend, një strehë pa luftë në botë. Ky libër i autorit bestseller ndërkombëtar Khaled Hosseini është një përgjigje e qartë ndaj krizës së refugjatëve sirianë, frymëzuar nga imazhi që tronditi botën i Alan Kurdit 3-vjeçar, që u gjet i mbytur, pa jetë në një nga plazhet e Turqisë. Shkruar në formën e një letre, "Lutje detit" është një reagim i babait, ndërsa shikon djalin e tij në gjumë, në udhëtimin e rrezikshëm nëpër det, që shtrihet përpara tyre. Është, gjithashtu, një pasqyrë e jetës së tyre në Homs, Siri, para luftës dhe e shndërrimit të shpejtë të atij qyteti nga një vend i qetë në një zonë vdekjeprurëse lufte. Libri është realizuar në bashkëpunim me UNHCR-në, Agjencinë e Kombeve të Bashkuara për Refugjatët dhe fillimisht është promovuar si film virtual i Guardian-it në shtatorin vitit të kaluar.

LIBRI

Ky tregim poetik i rrefyer me shumë intensitet, në përkujtim të përvjetorit të tretë të vdekjes së Alan Kurdit 3-vjeçar, trupi i pajetë i të cilit u gjet në një breg të Turqisë, në shtator të vitit 2015, e duke shkaktuar zemërim në mbarë botën, hapet me përshkrimin e një plazhi të ndriçuar nga drita e hënës, ku një baba mban në krah të birin që fle, tekta presin zbardhjen e agimit dhe mbërritjen e varkës. Tregimi është konceptuar si një letër nga një baba i frikësuar sirian për djalin e tij, në prag të kalimit nëpër detin e pabesë për në Europë. Ai i flet të birit për verën e gjatë të fëmijërisë së vet, duke kujtuar shtëpinë e gjyshit në Siri, zhurmërimen e degëve të ullinjve që i trazonte era, blegërimin e dhisë së gjyshes së tij, përplasjet e kusive të gatimit. Dhe kujton po ashtu jetën paqësore të familjes si edhe botën gjithë gjallëri të Sirisë para luftës civile, fushat me lule dhe tregjet e mbushura plot e përplot në qytetin e Homsit, me rrugët plot me njerëz, me xhaminë dhe Souk-un e tij të madh, përpara se qielli të niste të derdhte bomba e qyteti të shndërrohej në një zonë lufte vdekjeprurëse dhe ata të detyroheshin të merrnin arratinë. Duke shkruar në vetën e parë, Hosseini e

kontrastin me sukses Homsin, një qytet gjithë jetë para luftës, të cilin vogëlushi e ka njohur, me një qytet të shkatërruar nga bombat, uria dhe vdekja. Kontrasti është shprehur përmes stilit lirik të Hosseinit, që na jep fuqimisht në mënyrë të drejtpërdrejtë gjendjen në të cilën ndodhen popullatat e detyruara të zhvendosen, por, gjithashtu, është realizuar në mënyrë grafike në një nivel të lartë artistik, përmes një ndryshimi të theksuar të penelatave të Williamsit me akuarel. Ngjyrat e qiellit dhe të ujit, të dyja ndërthuren emocionalisht me tekstin dhe i paraqesin figurat e njerëzve të vogla e të brishta. Së bashku, ilustrimet joshëse dhe proza e hijshme dhe emocionale e bëjnë të qartë se Maruni dhe prindërit e tij nuk kanë zgjidhje tjetër; përveçse të kenë besim te deti. Babai i flet të birit për shtëpinë, shpresën dhe frikën. Kur të lindë dielli, ata dhe të tjerët përreth tyre do të mblehjin plakët e do të nisen në një udhëtim të rrezikshëm në det drejt Europës, në kërkim të një shtëpie të re. Pjesa e dytë e letrës është një lutje për një udhëtim të sigurt. Është fuqishëm evokimi i gjendjes në të cilën popullatat e zhvendosura e gjejnë veten duke marrë përsipër një udhëtim, megjithëse janë të ndërgjegjshme ndërkohë për pasigurinë e tij, por, që, megjithatë për ta është e vetmja mundësi që të shpëtojnë familjet e tyre. Libri lexohet si një tekst sintetizues tepër tronditës. Është e pamundur të lexosh pa ndier dhembshuri për ata njerëz që kanë lënë shtëpitë e tyre, për t'i shpëtuar luftës shkatërrimtare, nga të cilët sot ka mijëra të tillë nëpër botë, që u ngajjnë personazheve në libër. Kjo letër, me fjalët tepër emocionuese që shpreh, dëshmon në vetvete një akt të madh dashurie. Në ato rreshta ndiejmë shpresën e frikën, lumturinë e dhembjen. E pamundur të mos i ndiejmë dhe të mos i aprovojim ato fjalë, kur mund të mendojmë se në vend të atij babai dhe atij fëmije atje, mund të ishim vetë ne. Gjithashtu, është e



Khaled Hosseini


pamundur që duke e njohur këtë realitet të qëndrojmë mënjanes, aq më tepër kur këto ngjarje zhvillohen pranë nesh.

SHKRIMTARI AFGAN

Hosseini tha se ai e kishte shkruar librin jo vetëm "për të ndihmuar në ruajtjen e kujtesës së Alan Kurdit, por edhe si një borxh që u kemi mijëra njerëzve që humbën jetën në det. Le të jetë një kujtesë për dëshpërimin që i detyron njerëzit të rrezikojnë gjithçka që kanë. "Por nuk është gjithçka në errësira". "Drita është një pjesë tepër e rëndësishme e punës sime", shpjegoi Williams "dhe simbolikisht kjo sjell një nivel shprese. Duhet të ketë gjithmonë një element shprese".

TOP OF FORM
BOTTOM OF FORM

Khaled Hosseini, autori i romanit të famshëm "Gjue-



Shqetësimi i babait për të birin tekta kalojnë detin për në Europë

tari i balonave" dhe Ambasadori i Vullnetit të Mirë të UNHCR, agjencia e refugjatëve të Kombeve të Bashkuara, rrefen rreth asaj se si gjendja e refugjatëve sirianë dhe vdekja e trevjeçarit Alan Kurdi e shtynë atë të shkruante librin e tij të fundit.

Bota është një vend tjetër nga ai që mbetet pa Alan Kurdin. Mbytyja e tij në detin Egje tre vjet më parë, ndryshoi ligjërimin publik dhe u hap i sytë njerëzve ndaj traumave të refugjatëve dhe luftës siriane e shpreson se tragjedia e Kurdit mund të sensibilizojë mbarë opinionin botëror. Në fakt, Hosseini nuk i përshtatet stereotipit të një refugjati. Ai është mjek dhe autori i romanëve tepër të njohur "Gjueitari i balonave", "Një mijë diej vezullues" dhe "Dhe malet oshinë". Kur Hosseini arriti në Shtetet e Bashkuara në moshën 15-vjeçare, nuk fliste anglisht. Familja e tij kishte ardhur nga Franca, ku babai i tij kishte punuar si diplomat në ambasadën afgane në Paris për katër vjet. Ata kërkuar azil në SHBA pas grushtit komunist të vitit 1978. Kthimi në Afganistan ishte i pamundur, shpjegoi ai, por në të njëjtën kohë ishte ajo që ne

dëshironim. "Prindërit e mi kishin tokë, kishin shtëpi, kishin një rrjet të gjerë familjar, miq, karrierë etj., kështu që, në kohëra ideale, ne të gjithë donim të shkonim në shtëpi".

Khaledi kujton: "Kur pyes veten se çfarë do të kishte ndodhur, nëse nuk do të ishim pranuar në SHBA, nuk gjejmë asnjë përgjigje. Kthimi në Afganistan nuk ishte një opsion. Kur ndodhi grushti, ne të gjithë dëgjovim lajme duo ditë: kush po burgosej, kush ishte zhdukur, cili ishte pushkatuar. Nuk njoh ndonjë familje që të mos jetë prekur në njëfarë mënyre". Një nga xaxhallarët e tij, gjykatës, u torturua për nëntë muaj dhe mbijetoi i traumatizuar, si hije e ish-vetës së tij; një tjetër i shesht u zhduk pasi e paraburgosën. Hosseini zbaranoi në San Jose dhe ka qetë atëherë ka qendruar e ka jetuar atje.

Dëshira për t'u kthyer atij i lind herë pas here në takimet e tij me refugjatët. "Të gjithë duan të kthehen në shtëpi, por frika e persekutimit është diçka që unë mund ta kuptoj shumë mirë, sepse kujtoj ato biseda që bënim prindërit e mi kur ishim në Francë, për peshën e vendimit që duhet të mar-

rësh, nëse largohesh nga atdheu". Kujtimi i shtëpisë, i një jete të mëparshme - thotë ai, "është ajo që i mban shumë njerëz gjallë, gjithmonë duke shpresuar në të ardhmen".

Romancieri e përshkruan veprën e tij të fundit, "Lutje detit", si një borxh të tij ndaj djaloshtit që iku nga Kobane e Sirisë veriore, për t'i shpëtuar luftës civile dhe rrezikut të Shtetit Islamik, vetëm për të gjetur një vend të ri në paqe.

"Shpresoj, gjithashtu, që ky libër të lexohet gjerësisht, se kjo ndihmon që të kuptohet dëshpërimi i paimaginueshëm me të cilin përballen mijëra familje të tjera që janë detyruar nga dhuna dhe përndjekja të braktisin gjithçka që kishin dhe duke sakrifikuar të kryejnë një kalim jashtëzakonisht të rrezikshëm përmes detit", thotë autori.

Vëllimi "Lutje detit" është reminiscencë e babait të një Sirie të humbur përgjithmonë dhe një parashikim për një udhëtim të pabesë nëpër det, për një të ardhme larg bombardimeve, urisë dhe vdekjes. Ai tregon për zgjedhjen që bëni një baba, pasi është lufta ajo që e nxit atë për të marrë familjen e tij dhe për ta shpër nga një rrezik në tjetrin në kërkim të paqes dhe sigurisë. Përkishtë kjo marrëdhënie midis babait dhe djalit është ajo që tronditi Hosseinin tre vjet më parë dhe e nxiti atë të shkruante "Lutje detit". "U kujtim të Kurdit dhe familjes së tij. "Edhe unë kam dy fëmijë", thotë Hosseini. "Kur e pashë fotën e trupit të pajetë të Alan Kurdit në atë plazh të Turqisë, u ndjeva edhe unë i pajetë, gjithashtu". "U mundova të kuptoj dhimbjen që babai i tij duhej të duronte çdo herë që shihte fotën e djalit të tij të vdekur në atë plazh në Turqi, ose në një të huaj që e nxjerr trupin e fëmijës së tij nga uji, një i huaj që nuk di asgjë për Alanin, për lojërat e tij të preferuara, të qeshurës e tij, ose ushqimin e tij të parapëlqyer". Khaled Hosseini do të dhurojë të gjitha të ardhurat nga shitja e tij nga libri i tij në UNHCR.

FESTIVALI MBARËKOMBËTAR I TEATRIT

Fatmira Nikolli

Jeni të gjithë të dënuar. Jeni të dënuar që keni lindur e jetoni në këtë vend. Dënoheni të jetoni pa shpresë. Dënoheni të mos keni fuqi të luftoni. Dënoheni të mos keni guxim për t'u revoltuar, as për të ushqyer idenë e lirisë". Kur thuhet këto fraza shfaqja ka mbaruar, Kaligula ende i ka buzët me gjak nga kafshimi, ka vrarë ndërkaq të gjithë ata që kishte përreth, sepse siç e pranon perandori i çmendur "Unë jetoj. Unë vras. Kjo do të thotë të jesh i lumtur. Ti ke faj, por të vrasësh nuk është zgjidhje". Krismat janë të forta, trupat bien mbi një dheme të pluhurosor ku perandori ka kërcyer e ulëritur i veshur me tutu. E megjithatë, ai i (për)dhuron të gjithë dhe ata nuk flasin, madje pothuaj i përulen, ifyten të gjithë, i përdor të gjithë dhe kur është shumë vonë edhe veten.

Sekush, mund të identifikojë tek ai pushtetin e tejskajshëm dhe keqpërdorimin e tij. Tmerrri i dhunës, o padrejtësisë vjen i gjallë, me aq vërtetësi sa duket se nodoh vërtetë para syve tanë.

Shfaqja "Kaligula" erdhi në skenën e Universitetit të Arteve nga trupa e Teatrit të Prishtinës, në kuadër të Festivalit Mbarëkombëtar të Teatrit. Sinopsi tregon që Kaligula është historia e një princi relativisht të dashur në fillimet e mbretërimit. Pas vdekjes së Drusilës, njëherësh motra dhe e dashura e tij, ai kupton se bota nuk është e kënaqshme. Prej këtij çasti, i helmuar nga përbuzja dhe tmerrri, ai tenton përmes vrasjeve dhe perversitetit sistematik të ushtojë një liri të shfrenuar. Por ajo që nuk thuhet nga teksti përcillet nga aktorët e Kosovës, që për më shumë se 1 orë e 30 minuta në një skenë të boshatisur ku ka vend vetëm për 2 skela dhe projeksonin e një hëne që simbolizon të pamundurën sjell gjithë çmenduritë e pushtetit.

"Po unë i shërbej një të madhi, po ti kuji i shërben, virtytit? Ju kam parë ju të ndershmëve, ju nuk keni guxuar", - a nuk është ky përcjimi i përditshëm i të ndershmit që vuan se ka zgjedhur të jetojë me dinjtet? Pjesa e shkruar nga Albert Kamysë, një ndër më të fortat e tij, në kuadër të absurdit, tekta merr si personazhin perandorin romak, mendohet se portretizon Hitlerin. Me regji të Kushtrim Koliqit dhe interpretimin e aktorëve Adrian Morina, Allmir Suhodolli, Ard Islami, Armend Baloku, Besart Sllamniku, Gresa Palaska, Meli Qena, Shkëlzen Veseli dhe Ylber Bardhi, është



"Kaligula", çmenduria e perandorit dhe vetmia e revolucionarit

të përpunuar që t'i flasë edhe Kosovës. Frazat që nuk i takojnë Kamysë vënë para kangjellave të gjykatës fajtorët që kanë manipuluar listat e veteraneve, që kanë fryrë buxhetet për 11 baxhanakë, për 3 gjyshe, për 120 rritje gjoksi, për 16 operacione hunde dhe që kanë ngurit 50 universitete për të dhënë 2 milionë diploma për 2 milionë banorë. Vënë para gjykatës, ata që kanë zhbërë meritat e herojve të luftës e nuk u kanë siguruar nevojat më të para viktimave të luftës.

"Kjo gjykatë ju akuzon për kapje të drejtësisë", - dhe të akuzuarit heshtin.

"Kjo gjykatë ju dënon të lëpini dyshemenë e saj. Të mësoni himnin e Koresë dhe t'i tregoni barsoleta fotos së Merkelit derisa a bëni të qeshë", reciton aktorja.

Salla qesh. Me mjerimin e saj. Me drejtësinë e saj. Me abuzimet e saj. Sepse shfaqja



Shfaqja nga Kosova ngre sallën në këmbë

në tërësinë e vet, në të gjitha elementet skenikë dhe në ato tekstuale e vë gishtin të secili prej nesh, te ne që jemi në sallë e tek ata që janë në lozhë. Të gjithë duartrokasin për të larguar prej vetes ndërgjegjen e prekur prej Kamysë, por qeshja jonë është njëherësh nënqeshja jonë.

Aktorët e veshur me të zeza mbajnë zinë e kobës së rënë, sepse kur nisen për në revolucion duke kënduar, tekta hedhin hapa e këndojnë janë bashkë. Më pas ikin një e nga një në mes. Dhe kur arrihet në fillim të skenës, është vetëm një zë që shqipton: REVOLUCION.

Marshimit i kanë ikur të gjithë, jo vetëm vijës së parë. Nëse u shitën a u blenë, nëse u penduan a u kërcënuan, nëse patën frikë nga vdekja

a nga jeta, kjo, pak rëndësi ka. Secili e zgjedh vetë arsyen e vet më të lehtë. E vërteta e fundme është se revolucionari nuk fiton dot i vetëm dhe se faji i humbjes nuk është i tij. Mesazhi i pakohë, e për këtë i gjithëkohshëm është i qartë. Pa sallanete skenografike e lostunesh, me elemente minimalistë e mu për këtë më të rrokshëm, pa nevojë për tallava e për komedi fundjave, Kaligula e Kosovës është me gjasë një prej arsyeve më të mira pse mbahet ky festival. Është gjithnjë më mirë t'i bësh masat të mendojnë se të këndojnë. Teatri këtë do duhet të kishte si mision më shumë se sa argëtimin pa bosh, që mbledh shumë spektatorë po njërr pak publik.

"POLITIKANËT E VRASIN KULTURËN SEPSE E PËRÇMOJNË, POR EDHE SEPSE IA KANË FRIKËN"

Plasari: Një libër që duhet përkthyer edhe në shqip

Përmes një postimi në profilin e tij në "Facebook", studiuesi Aurel Plasari sjell në vëmendje atë që e quan një libër për "vrasësit e kulturës", që sipas tij duhet përkthyer edhe në shqip. Bëhet fjalë për Nuçio Ordine, "La utilidad de lo inútil. Manifesto- Con un ensayo de Abraham Flexner", ed. Acanthillado 2013. Nga parathënia, ai veçon: "Dija përbën në vetvete një pengesë kundër delirrit të të plotfuqishmërisë së parasë dhe të utilitarizmit. Gjithçka mund të blihet, afërmendsh. Që nga parlamentarët deri te gjyqtarët, që nga pushteti deri te sukcesi: çdo gjë ka një çmim. Por jo dija:

çmimi që duhet paguar për të ditur është i një lloji krejt të veçantë. As edhe një çek i bardhë nuk të mundëson të fitosh mekanikisht atë që mund vetëm të jetë fryti i një përpjekjeje individuale dhe i një pasioni të pashtershëm. Në fund të fundit, pa motive të mëdha të brendshme, as titulli më prestigjioz i fituar me të holla nuk të sjell asnjë dije të vërtetë dhe nuk të shkakton asnjë metamorfozë të vërtetë të shpirtit". Në vijim, Plasari sjell pjesë të tjerë prej tij, si kjo: "Por ka edhe diçka më shumë. Vetëm dija mund t'i sfidojë një herë e mirë ligjet e tregut. Unë mund t'i ndaj bashkë-



pa u varfëruar për vete. Mund t'i mësojë një nxënësi a një studenti teorinë e relativitetit ose të lexojë tok me të ndonjë faqe të Montaigne-it, duke i dhënë jetë mrekullisë së një procesi virtuoz gjatë të cilit pasurohen edhe ai që jep, edhe ai që merr".

Në vijim, Plasari shkëput nga Nuçio Ordine, "La utilidad de lo inútil. Manifesto", edhe këtë pjesë: "Nëse e lëmë të vdesë 'produktin falas', dmth. kulturën, nëse heqim dorë nga fuqia gjeneruese e

'të padobishmes', nëse dëgjojmë vetëm këngën zindjellëse të sirenavë që na joshin të ndjekim përfitim, atëherë do të jemi të aftë vetëm të prodhojmë një kolektivitet të sëmure dhe të pakujtesë që, i rravruar, do ta humbë më në fund kuptimin e vetvetes dhe të jetës. Dhe, në atë moment, kur shkretëtirëzimi i shpirtit do të na ketë tharë krejt, do të jetë përnjëmend e vështirë të përfytyrojmë që një 'homo sapiens' injorant të mund të lozë ende ndonjë rol në detyrën për ta bërë më njerëzor njerëzimin".

Përse luan politika në emërimet për Gjykatën e Lartë?

"Zëri i Amerikës"

...Kjo temë është shndërruar në betejë politike mes dy partive kryesore.

Ka një numër arsyesh përse kjo kandidaturë po zgjon kaq shumë përçarje mes demokratëve dhe republikanëve. Brett Kavanaugh është i emëruari i dytë i Presidentit Trump për Gjykatën e Lartë. Ashtu si i emëruari i mëparshëm Neil Gorsuch, Kavanaugh është zotuar se vendimet e tij nuk do të ndikohen nga rrymat politike. Por në shekullin e 20, të nëntë anëtarët e Gjykatës së Lartë kanë votuar gjatë viteve në përputhje të qartë me ideologjinë politike.

Nga viti 1969-1986, mesatarisht 17% e lëndëve gjyqësore u vendosën me shumicë të ngushtë prej 5 votash pro e 4 kundër. Në vitet në vijim, ky raport u vërejt në 20% të lëndëve dhe më pas në 22%.

Në fillimet e Gjykatës së Lartë vendimet merreshin shumë më ndryshe. Nga 1801-1940, vetëm në 2% të rasteve kishte vendime me një shumicë prej vetëm një vote. Kjo dëshmon se me kalimin e viteve, gjykatësit e kanë pasur gjithnjë e më të vështirë të bien dakord për çështje të ndryshme. Po ashtu, vërehen grupe të caktuara brenda gjykatës me një mendim identik mes tyre.

Për shembull, në mandatin e fundit të Gjykatës së Lartë që përfundoi në qershor, i njëjti grup i përbërë nga pesë gjykatës dha vendimin në 13 lëndë; i njëjti grup prej katër gjykatësish përfaqësoi mendimin opozitar. Grupi në shumicë, i përbërë prej pesë gjykatësish, konsiderohen si anëtarët konservatorë të institucionit, ndërsa katër të tjerët konsiderohen si anëtarët liberalë.

Kjo ndarje në pikëpamje mes anëtarëve aktualë të gjykatës duket se ka ndërlikuar edhe procesin e konfirmimit për gjykatësin Brett Kavanaugh. Zoti Kavanaugh konsiderohet si gjykatës me pikëpamje konservatore dhe konfirmimi i tij shihet si një konsolidim i krahut konservator të Gjykatës së Lartë.

PËRÇARJA POLITIKE

Kjo përçarje në vija partiake lidhur me gjykatën pasqyron përçarjen e përgjithshme politike në Shtetet e Bashkuara. Gazetari Alan Greenblatt shkruante në 2004-ën për revistën "Congressional Quarterly" se në fillim të viteve 2000, votuesit ishin të ndarë thuajse bars në grupe me pikëpamje përgjithësisht konservatore dhe grupe me pikëpamje përgjithësisht liberale. Për të fituar vota, tha zoti Greenblatt, politikanët filluan të përqafojnë qëndrime më ekstreme.

Një artikull i vitit 2014 në revistën "New Republic" mbështet idenë e zotit Greenblatt. Në ar-



tikull thuhet se gjatë gjysmës së dytë të shekullit të 20, ligjvënësit që konsiderohen si politikanë me pikëpamje të moderuara janë pakësuar nga 45% në 10%.

Gazetari Greenblatt thotë se kjo rënie në numrin e politikanëve të moderuar ishte pjesë e një plani politik. Sipas tij, në mes të viteve 1990, ligjvënësit në Partinë Republikane u angazhuan në sulme personale ndaj demokratëve, duke mbytur zërat e moderuar dhe duke ndëshkuar zyrtarët që bashkëpunonin me partinë opozitare. Plani i tyre dha rezultat, pasi u siguroi republikanëve më shumë vende në Kon-

gres. Demokratët u përgjigjën duke përdorur të njëjtat metoda. **AMERIKANËT BESOJNË SE PËRFAQËSOJNË PIKËPAMJE TË QENDRËS**

Amerikanët sot nuk janë aq të përçarë në vija partiake sa ç'i prezanton media dhe politikanët thonë studiuesit në Qendrën Kërkimore "Pew". Një anketë e fundit arrin në përfundimin se më shumë se gjysma e amerikanëve e konsiderojnë veten të moderuar. Edhe ata që e shohin veten si të lidhur me një parti të caktuar politike besojnë se janë më të moderuar se partia së cilës i përkasin.

Megjithatë, anketuesit zbuluan se amerikanët i konsiderojnë pikëpamjet e partisë opozitare si ekstreme. Pra, amerikanët i shohin ata që përqafojnë pikëpamje kundërshtare si tepër partiakë, megjithëse ai person mund të besojë se vetë është i moderuar. **SI NDIKON KJO PËRÇARJE TË GJYKATËS E LARTË?**

Klima politike në Amerikë ka marrë tipare gjithnjë e më partiake. Në këtë vazhde, shumë amerikanë po e shohin edhe Gjykatën e Lartë si një institucion politik.

Në 1987 doli haptas ideja se anëtarët e Gjykatës së Lartë mund të shlieshin si pasqyruet të bindjeve politike të një partie. Në atë kohë po zhvillohej procesi i konfirmimit të gjykatësit Robert Bork. Demokratët e bllokuan kandidaturën e tij, pjesërisht pasi ishin kundër bindjeve të tij mbi abortin dhe të drejtat civile.

Bork paralajmëroi se nëse të emëruarit për Gjykatën e Lartë trajtoheshin si kandidatë politikë, do të dëmtohej besimi i publikut te ky institucion. Por, në fillim të shekullit të 21, një numër votuesish i kërkoi gjykatës të reflektonin bindje të caktuara në vendimet e tyre.

Kompania e anketimeve "Gal-

lup" pyeti amerikanët për këtë ide në 2005 dhe 2018. Gjysma e tyre besonin se ligjvënësit mund të refuzonin një kandidat nëse nuk ishin dakord me pikëpamjet e tij për tema të nxehta si armëmbajtja apo aborti.

Një opinionist që shkruan për gazetën "San Francisco Chronicle" shkruante në fillim të vitit mbi arsyet përse emërimet për Gjykatën e Lartë janë kthyer në një betejë kaq të ashpër. Opinionisti Jonah Goldberg vë në dukje se fuqia e Gjykatës së Lartë është rritur ndjeshëm në qeverisjen e vendit. Ai thotë se në shekullin e 20, liberalët filluan ta shfrytëzojnë gjykatën për të krijuar politika e ligje që duhet të ishin në dorë të presidentit, të ligjvënësve, ose qeverisjes vendore.

Elementët partiakë në të djalhtë të spektrit politik reaguuan duke i shndërruar emërimet në Gjykatën e Lartë në betejë politike. Në 2016-ën, gjatë fushatës presidenciale, kandidati Donald Trump premtoi se do të emëronte gjykatës konservatorë për Gjykatën e Lartë. Ky premtime ishte një ndër arsyet që i siguroi zotit Trump fitoren në zgjedhje, thotë opinionisti Goldberg.

Opinioni *i* Ditës

Ndarja e Kosovës, nënshtrimi para një ideje raciste

Nga Andi Bushati

... shteteve, pra serbëve të veriut në Kosovë dhe shqiptarëve të Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës. Si mund të lejohen ata të jetojnë në atë gjendje? Si mund të vazhdojnë të jenë qytetarë të dy shteteve që nuk i duan? Si mund të mbeten ata njerëz pengje të një konflikti që ka ngrirë prej dy dekadash? – është thelbi i përgjërimit të tyre.

Si ilaç për këtë, ata propozojnë shkëmbimin e territoreve, lëvizjet e popullsisë dhe shëmtinë e një spastrimi etnik pa luftë. Sepse kjo është, në fakt, ajo që do të ndodhë. Po të lexohet me vëmendje një speciale e gjatë që gazeta franceze "Le Monde" i kishte kushtuar kësaj teme (lexo përmbledhjen tek Lapsi.al) aty dallohen lehtësisht simptomat e asaj që pritet të ngjajë.

"Serbia ne na konsideron si të huaj, pse duhet të qëndrojmë në një vend që nuk na do?" i pohonte gazetarëve të "Le Monde" Shaip Kamberi, kryebashkiaku i Bujanovcit. "Nëse ndryshohen kufijtë Gračanica do të zbrazet", paralajmëronte Zivojin Rakocević, i cili thoshte: "Kjo do të sjellë padyshim një spastrim etnik".

Nuk ka dyshim se nëse kjo gjë arrihet një ditë, Kosova pothuajse do të shpullohej nga Serbët dhe po ashtu edhe Serbia, nga ata pak shqiptarë që kanë mbetur.

Pra formula magjike e atyre që mbështesin idenë e Thaçit dhe Vuçiçit barabitet me lumturinë që arrihet duke jetuar brenda kufijve të kombit tënd.

Kjo zgjidhje etnikisht e pastër, sipas tyre, nuk do të lehtësonte vetëm fatet e disa mijëra vetëve që



jetojnë në zonat kufitare. Ajo do të na dhuronte një paqe afatgjatë, një njohje reciproke, dhe në mos çmime Nobel për arkitektët e marrëveshjes, gjithsesi një pozitë më të mirë ndërkombëtare për Kosovën dhe Serbinë.

Por vetëm se e gjithë kjo fabul ka një problem. Aspak të vogël.

Si Serbia dhe si Kosova, janë shtete që së paku publikisht kanë si busull në politikën e jashtme anëtarësimin një ditë në BE. Pra, pranimin në një familje që e ka lënë pas krahëve ekzaltimin e idesë të shteteve etnikisht të pastra për të përqafuar të tjera vlera. Jo më kot, Michael Roth ministri për Europën i një vendi si Gjermania, që ka dalë me shpatë në dorë kundër kësaj marrëzie, deklaronte pak kohë më parë se "e ardhmja e vendeve të Ballkanit Perëndimor është multietnike, multifatë dhe multikulturore".

Të pranosh se nuk e arrin dot këtë objektiv, se nuk je në gjendje të respektosh të drejtat qytetare të pakicave, se nuk përparon dot si shtet pa nxjerrë jashtë "të huajt", se nuk bëhesh funksional po nuk shkove drejt pastërtisë etnike, se nuk je në gjendje të kontrollosh ekzeset e politikave nacionaliste në një mjedis multietnik, kjo është para së gjithash një boomerang. Në mënyrë indirekte kjo do të thotë se je një shtet apo një vend, që ndryshe nga sa pretendon, je i papërgatitur kulturalisht për të shkuar drejt BE-së.

Madje edhe më keq akoma, të pranosh konceptin se e vetmja zgjidhje për të qenë në paqe, të qetë dhe për të përparuar genkësh të qenët një komb etnikisht i pastër, do të thotë të biesh në kurthin e mbartësve të ideve raciste që e shohin këtë pjesë të Ballkanit Perëndimor si të paaftë për

të absorbuar vlerat e Europës së qytetëruar.

Qoftë edhe për këtë, – përpos faktit se mund të hapë kutinë e Pandorës dhe të shkaktojë një reaktion zinxhir në Ballkan, -ideja e Vuçiçit që ndoshta nga halli e ka përqafuar edhe Hashim Thaçi, është një tezë që duhet kundërshtuar.

Sepse ndërkohë që predikon, arritjen e paqes përmes dialogut, ajo rrënon dhe minon bashkëjetesën, sepse, ndërkohë që shet një përparim drejt BE, ajo i jep argumente të gjithë atyre që na shohin si të padenjë për të qenë në atë familje, sepse ndërkohë që ekzaltton vlerat e kompromisit dhe marrëveshjes, ajo është, në fakt, simboli i pamundësisë së tyre.

Dhe pikërisht për këto, ajo nuk mund të jetë as një premisë për paqe afatgjatë.

Lapsi.al

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ

INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

HOROSKOPI

DASHI

Do të ndiheni shumë mirë nga ana shëndetësore, pavarësisht se do të kaloni një ditë plot tension. Ka gjasa që disa persona të rëndësishëm të tregohen të gatshëm të financojnë një projekt për ju. Përpiquani të shmangni grindjet me familjarët.

DEMI

Sot do të ndiheni shumë të lumtur. Do të përfshihen në një situatë, e cila do t'ju sjellë fitime financiare. Duhet t'i kushtoni më shumë rëndësi taksave. Ka gjasa që sot të kaloni një mbrëmje të mrekullueshme me bashkëshortin/bashkëshorten tuaj.

BINJAKET

Një ditë e dobishme për t'u qetësuar në shoqërinë e dikujt. Disa plane dhe projekte do të tërheqin vëmendjen tuaj. Verifikoni kredibilitetin dhe besueshmërinë e personit para se të bëni ndonjë investim.

GAFORJA

Keni nevojë të relaksoheni dhe të gjeni lumturinë mes miqve të ngushtë dhe anëtarëve të familjes. Financat do t'ju përmirësohen. Ka gjasa që të debatooni me partnerin/partneren tuaj për shkak të një feste, por do të mund t'ia dilni mbanë.

LUANI

Nënat shtatzënë të kësaj shenje duhet të bëjnë kujdes gjatë ditës së sotme teksa ecin. Do të kaloni një ditë fantastike me miqtë, por tregohuni të kujdesshëm kur ngjini makinën. Sot do vini në provë inteligjencën, pasi do të merri pjesë në disa lojëra që bazohen në dije.

VIRGJERESHA

Mbështetja e madhe nga ana e familjes suaj do të bëjë që të arrini rezultatet e duhura. Megjithatë duhet të punoni vazhdimisht dhe me të njëjtin ritëm që t'ruani këto rezultate. Gjendja financiare do t'ju përmirësohet, pasi do t'ju sjellin disa pagesa të prapambetura.

PESHORJA

Sot do të ndihni plot energji. Çfarëdo që t'ju dëshirojë, ju do të mund ta realizoni shumë më shpejt se herët e tjerë. Ka gjasa t'ju vijë një letër, e cila do të kërtojë gjithë familjen. Do të kaloni një ditë fantastike me partnerin/partneren tuaj, ku do t'ju shprehni ndanë një jetë si asnjëherë më parë.

AKREPI

Nuk do të ndiheni të lodhur, pavarësisht një axhende të ngarkuar. Do të arri të fitoni para nëse kursimet i përdorni për disa investime të rëndësishme. Miqtë dhe anëtarët e familjes do t'ju inkurajojnë. Kërkesat e bashkëshortit/bashkëshortes tuaj do t'ju shkaktojnë stres.

SHIGJETARI

Do të jetë një ditë plot emocione pasi partneri/partnerja juaj do t'ju surprizojë me dhuratat. Do të merri disa komplimente, për të cilat do t'ju vijë një mirë që i dëgjon. Nëse keni kohë që prisni nga partneri/partnerja juaj t'ju shprehë dashurinë, kjo do të jetë dita juaj me fat.

BRICJAPI

Sot do të keni kohë mjaftueshëm, kështu që bëni mirë të shëtoni në favor të shëndetit tuaj. Do të kaloni një mbrëmje shumë të këndshme me miqtë. Sa i përket anës romantike, ka gjasa të debatooni me partnerin/partneren tuaj.

UJORI

Dashuria e partnerit/partneres suaj do t'ju ndriçojë ditën. Kohën e lirë dedikojni sot personave në nevojë, por mos u përfshini në disa çështje që nuk ju takojnë. Ka gjasa që sot të takoheni me një mik të vjetër, me të cilën do të kujtoni kohë shumë të bukura.

PESHQIT

Kontrolloni emocionet. Idetë e vjetra nuk do t'ju lejojnë të ecni përpara. Miqtë do të tregohen shumë të gatshëm për t'ju ndihmuar. Lidhja juaj romantike po bëhet gjithë e më fortë. Përpiquani ta shijoni sa më shumë.

VERILINDORËT DUAN TIPOZË



Kukësin në këtë sezon e kanë ndjekur kudo stadiumet e boshatisura. Mbyllja e "Zeqir Ymerit" në një afat të pacaktuar, ka bërë që skuadra të endet sa në një stadium në tjetrin dhe tifozët e saj as që kanë ndër mend ta ndjekin në Shkodër apo Elbasan ku ka luajtur si ndeshjet e Europës, ashtu edhe të kampionatit. Një situatë absurde, për të cilën në klub duan të gjejnë zgjidhje sa më parë pasi skuadra që syn-

Stadiumi bosh në çdo ndeshje, Kukësi "ëndërron" të luajë në Kamëz

on titullin kampion rrezikon të luajë gjithë vitin pa pasur mbështetësit pranë. Sipas "SuperSport", në ambientet e klubit ka filluar të diskutohet një hipotezë mjaft interesante e zhvillimit të ndeshjeve në Kamëz. Duke qenë në dijeni të ekzistencës së një komuniteti të madh nga qyteti verilindor

që banon në Kamëz, prania e shumë syresh në stadium do të ishte më se e garantuar duke bërë që Kukësi të ndjehet në shtëpi. Kështu, po mendohet që të nisën bisedimet me drejtuesit e Bashkisë së Kamzës, nëse është e mundur të realizohet një gjë e tillë. Por problemi më i madh është kal-

endari i kampionatit i cili ka vënë dy skuadrat përkrah njëra-tjetrës sa i përket zhvillimit të ndeshjeve. Kështu, në javët kur Kamza është pritëse, edhe Kukësi është i tillë. Ndaj zhvillimi i ndeshjeve në stadiumin e Kamzës do të ishte thuajse i pamundur me rregullsi të plotë, pasi do të dëmtonte stadiumin duke zhvilluar dy ndeshje brenda pak ditësh në këtë impiant.

Kampionët kanë sulmin më të mirë në kampionat, por 8 gola janë shënuar nga 5 lojtarë



Jeton Selimi

Gola nga çdo repart, ja si Skënderbeu po dominon

Oto Xhon dhe Bregu kanë nga dy gola

Sezon i ri, Skënderbeu i vjetër. Shifrat e këtij fillim kampionati konfirmojnë supremacinë e skuadrës korçare, që edhe pse i është nënshtruar verën e shkuar një ristrukturimi të thellë, vazhdon të mbetet dominuese në gjuhën e ftohtë të statistikave.

Skënderbeu ka sulmin më të mirë të kampionatit, 8 gola të shënuar, në 5 javë, dy më tepër se ndjekësit e Kukësit, por ndryshe nga verilindorët, ku peshën absolute e mban Rexhinaldo me 4 finalizime, geografia e golit në kampion korçar është më e shpërndarë, pasi mbi të gjitha shënojnë të dy sulmuesit e destinuar për të luajtur në majë të skuadrës. Blerim Krasniqi mposhti me golin e tij Flamurtarin, ndërsa Oto John është në kuotën e dy finalizimeve, po aq sa Deji Bregu, një tjetër rrezik konstant për rivalët në vijën e parë të Skënderbeut, apo Muzaika një tjetër lojtar që Superioreen e njeh në perfeksion, ndërkohë që ka shijuar golin e parë dhe Demte.

Plot 5 lojtarë të aftë për të gjetur rrjetën në 5 javët e para është një shifër domethënëse. Edhe për sa i përket mbrojtjes, Skënderbeu është një ndër skuadrat më të vështira për t'i shënuar, me vetëm dy gola të pësuar, ndërsa më mirë se skuadra e Shehit në këtë aspe-



kt, deri më tani ka bërë vetëm Partizanin që në 5 javë ka nxjerrë topin vetëm një herë nga rrjeta. Aftësi për të rikuperuar është ndërkohë një tjetër e dhënë që flet për personalitetin e një skuadre që di të reagojë edhe kur gjendet në disavantazh, si në takimet me

Laçin apo atë të fundit me Tiranën kur Skënderbeu riktheu ekuilibrin vetëm në minutat e fundit, jo më kot Skënderbeu bashkë me Laçin është një ndër dy skuadrat e vetme që ende nuk kanë pësuar një humbje në këtë kampionat, por ndërkohë kurb-

asit kanë mëkatuar ndoshta më shumë se sa pritej në barazime. Është vetëm fillimi i kampionatit, por shifrat e 5 javëve të para, konfirmojnë seriozisht një Skënderbeu para rivalëve të detyruar deri më tani të mbeten në ndjekje të kampionëve në fuqi.

YLLI BELG

Hazard i mbyll derën Recalit, do të rinovojë me Çelsin

I kërkuar në çdo merkato e një ndër më të daluarit në kampionatin anglez, Eden Hazard duket se i ka dhënë fund aludimeve në lidhje me të ardhmen e tij. Ylli belg i Çelsit ka vendosur që të qëndrojë në "Stamford Bridge" duke i mbyllur derën edhe për merkaton e ardhshme Real Madridit. Sipas medieve britanike, është arritur akordi me Çelsit dhe futbollistit për rinovimin e kontratës që do të bëhet gjatë javës tjetër dhe pritet që të zgjasë deri në verën e vitit 2022. Për sulmuesin që po shënon rregullisht në Premier Ligë, ka pasur një interesim konkret nga madrilënët në këtë merkato, duke qenë se ai shihet si futbollisti i denjë për të zëvendësuar Kristiano Ronaldon. Aktualisht, kontrata e belgut skadon në vitin 2020 dhe rinovimi me 2 vite të tjera përkethehet në shumë përfitime personale, duke qenë se parashikohet edhe rritje e pagës së belgut. Vlera e tij, sipas transfermarkt arrihet deri në 110 milionë euro, por për shërbimet e tij, klubet e interesuara do të duhet të paguajnë më shumë se kaq.

INDONEZI

Godasin deri në vdekje tifozin kundërshtar

Një ngjarje e tmerrshme ka ndodhur në Indonezi gjatë një ndeshje midis klubit të Persib Bandung dhe Persija Jakarta, rivalë të përbetuar me njëri-tjetrin. Qindra tifozë të klubit Persija Jakarta kanë goditur me shufra hekuri një tifoz të Persib Bandung duke e lënë të vdekur në vend. 23-vjeçari Haringa Sirla ndërroi jetë pasi nuk arriti t'i përballonte plagët e marra. Ndërsa policia indoneziane ka njoftuar se ka arrestuar 16 veta, të cilët kanë qenë pjesëmarrës në këtë sulm ndaj të riut. Më pas ka reaguar edhe Federata Indoneziane e Futbollit, e cila e dënon ashpër rastin në fjalë si dhe shpreh ngushëllimet për të afërmit e viktimës.

ISH-TRAJNERI I ITALISË

Emri i Antonio Kontes qarkullon prej disa muajsh në ambientet e futbollit italian, që nga momenti kur u bë e qartë se ai do të largohej nga Çelsi. Emri i tij u përmend shpesh si një objektiv i Milanit për këtë sezon, por te kuqezinjët preferuan që të mbanin në detyrë Gatuzon. Megjithatë, për Konten është krijuar një tjetër mundësi e mirë, pasi stoli i një ekipi të madh të Serisë A ka filluar të lëkundet. Bëhet fjalë

Konte drejt rikthimit në Serie A, e pret Roma



për Romën, e cila pah humbjes ndaj Bolonjës të cilën e vlerësoi edhe presidenti i saj Pallotta si "të neveritshme", po sheh mundësinë e largim-

it të Di Françeskos. Sipas "La Stampa", drejtuesit e skuadrës mendojnë seriozisht të afrojnë një emër të ri në stolin e ekipit dhe Konte duket emri i duhur falë profilin që ka dhe padyshim eksperiencave të rëndësishme në karrierë. Nëse Roma nuk bën kthesën shpejt, prezantimi i Konte me shallin e skuadrës në qafë nuk duket i largët.

Federata detyrohet të marrë masën e parë


Grima në "arrest me burg", FSHF e pezullon nga detyra



Armir Grima ka qenë trajneri i Kombëtares së femrave në futboll, por edhe drejtues i stadiumit "Loro Boriçi" në Sh-

kodër. Tani FSHF-së i duhet të gjejë drejtues të tjerë për të drejtuar Kombëtaren e femrave, pasi procesi gjyqësor nuk dihet sa do të zgjasë. Ajo që bën përshytyje në lidhje me vendimin e FSHF-së është se Grima është pezulluar përkohësisht dhe jo shkarkuar, siç duhej vepruar në një rast të tillë nga një Federatë normale.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Ishin shkruarit e lashtësisë.
6. Eshhtë monark.
10. Fillojnë tatëpjetën.
11. Nunez de, që u mbiquajt "Admirali i detrave të Jugut".
13. Një "bombë" tenisike.
15. Mbyllin punishtet.
16. Maria de la Felicidad, që qe mexosoprano e famshme.
21. Kështu thirret Billie Holiday.
22. Kaçaturian kompozitor.
24. Një poezi.
25. Kapitulli i shkurtër.
27. Janë katolikët e Libanit.
30. Brezi për të lidhur një kimono.
31. I sëmurë i... keq.
33. Një sigël plastamsi.
34. Jaëvirgjereshat e parajsës islamike.
35. Ishte gjuha e Jezu Krishtit.

38. Agjenci Ndërmjetëse Rajonale.
 39. Janë të ndryshme në liri.
 40. Arthur i Pamje nga ura.
 42. Poetja e Lesbos.
 45. Delon aktor.
 47. Beton pa kufij.
 48. Franco, regjisori i Jezusi i Nazarethit.
 50. Mbetet në fun.
 51. Kështu bie... heroi.
 52. Mbyllin akte.
 53. Garfunkel i muzikës.
- VERTIKAL**
1. Eshhtë birrë e jona.
 2. Një i fundit eshtë mbi të gjithë.
 3. Një gjigant i computer-ëve.
 4. Ishte kryepërandi e kaldejve.
 5. Fizgerald që qe këngëtare e famshme.
 6. Ndiqet nga apiteni Achab.
 7. Ishin rapsodë të keltëve.
 8. Fillojnë tatëpjetën.
 9. Kështu përfundon një polic.
 12. Janë barakar e Rio de Janeiro-s.
 14. Jashtëtokësori i Steven Spielberg.
 17. Binjaket në klasa.
 18. Kështu përfundon një pony.
 19. Eshhtë "çatia e botës".
 21. I formojnë... kryeministrat.
 23. Nikita, që qe pianist i famshëm zviceran.
 25. Janë këngët e Pax Dei.
 26. Lunaire i Schönberg.
 28. Topat pa kufij.
 29. Inicialet e Harris, aktor.
 32. Nota e diapazonit.
 36. Kufizojnë një mister.
 37. Zola i J'accuse.
 41. Një pjesë e iniciativës.
 42. Saze pa zë.
 43. Skuadër greke.
 44. Inicialet e Franchi, që qe komik italian.
 45. Një eshtë edhe grizzly.
 46. Carol, aktore.
 49. Inicialet e Lendl, ish-tenist.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Eshhtë trupi i fortë.
5. Eshhtë natë në një film të famshëm të François Truffaut.
9. I famshmi Pacino.
10. Crusoe i Defoe.
14. Vodhi Palladin me Odiseun.
16. Një atë shpirtëror indian.
18. Lindi nëntë muza.
21. Të parat në enciklopedi.
22. Lihet një me... famë.
23. Jean-Luc, regjisori i For ever Mozart.
24. Një mund të jetë edhe gjeografike.
27. Wan Kenobi i Lufta e yjeve.
28. Kështu përfundon Ivanhoe.
29. Një reaksion në... provëz.
30. Rajone Lokale Ndërtimi.
31. Ekstremit në sektor.
32. Eshhtë botë e kafshëve.

VERTIKAL


1. Derisa mbarojnë.
2. Para Trafford në stadiumin e Manchester United.
3. Kështu thirret Mike Tyson.
4. Republika në Santo Domingo.
5. Inicialet e Shue, aktore.
6. Dario, nobelist italian.
7. Eshhtë lugina me Saint Moritz.
8. Mund të jenë picadores.
11. Janë vepra... kreshnikësh.
12. U kompozua nga Mozart.
13. Ndizet pa det.
15. Mi... ktheni mbrapsht.
17. Nën... 21 për futbollistët e Shpresës.
19. Princi i Borodin.
20. Me art tregon boksin.
24. Edith e La vie en rose.
25. Bedriu, ish mesfushir bardheblu.
26. Emri i Zizou.
29. Janë tek në kafe.
35. Smith, këngëtare punk rock.
37. Inicialet e Michael, këngëtar.
38. Një fazë gjumi.
40. Teket e rripit.
41. Me Ben në Westminster.
43. Një pune... paguhet.
44. Një këshilltar për negus.
45. Raste kur s'ka re.
47. Këndon Sex bomb (inic).
48. Fundi i një fundi.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|--|
| | | | 9 | 1 | 3 | | | |
| | 9 | | 5 | 7 | | | | |
| 2 | | | 6 | | | | 7 | |
| 3 | | | 8 | | | 1 | | |
| 5 | | 9 | | | | | 4 | |
| 6 | | | 3 | | | | | |
| 7 | | | | | 4 | | 9 | |
| 4 | | | 2 | | 5 | 8 | | |
| 1 | | | | 6 | | | | |

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3 | 5 | 6 | 9 | 8 | 7 | 4 | 2 | 1 |
| 9 | 4 | 8 | 1 | 2 | 3 | 6 | 7 | 5 |
| 1 | 2 | 7 | 4 | 5 | 6 | 9 | 3 | 8 |
| 7 | 3 | 2 | 8 | 9 | 5 | 1 | 4 | 6 |
| 5 | 6 | 1 | 2 | 7 | 4 | 3 | 8 | 9 |
| 4 | 8 | 9 | 3 | 6 | 1 | 2 | 5 | 7 |
| 6 | 9 | 4 | 7 | 3 | 8 | 5 | 1 | 2 |
| 2 | 7 | 3 | 5 | 1 | 9 | 8 | 6 | 4 |
| 8 | 1 | 5 | 6 | 4 | 2 | 7 | 9 | 3 |

Argëtim filozofik

- Nuk ka asnjë dallim midis një të mençuri dhe një budallai kur bien në dashuri.
- Nuk eshtë e mundur për të kuptuar njeriun me shikim të parë. Virtutet zakonisht i mbulon perçija e modestisë, ndërsa defektet veshin maskën e hipokrizisë.
- Sa më pak e meritojmë fatin e mirë, aq më shumë shpresojmë që të kemi.
- Në një shtet që qeveriset mirë, varfëria eshtë e turpshme. Në një shtet që qeveriset keq, pasuria eshtë turp.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | D | 3 | A | 5 | S | 7 | H | H | I | J | A | K | S | S | T | O | L | | | | | | |
| 9 | 6 | 1 | | 10 | 11 | 5 | 2 | 9 | 2 | 3 | A | N | E | T | D | A | F | H | L | T | | | |
| | 11 | 6 | 9 | 2 | 14 | 1 | 7 | 3 | 10 | | 11 | B | A | T | H | E | R | E | T | I | K | E | |
| 1 | 2 | 15 | 6 | 16 | 5 | 2 | 19 | 16 | 2 | 10 | I | T | H | O | N | O | R | A | R | I | T | | |
| | 5 | 2 | 16 | 10 | 3 | 11 | 5 | 3 | | 10 | T | K | A | P | I | T | A | L | I | S | T | E | |
| 10 | 14 | 10 | 19 | 9 | 6 | 10 | | | 18 | 10 | 9 | O | A | L | K | R | A | T | R | L | | | |
| | 19 | 9 | 3 | 9 | 6 | 3 | 5 | 2 | 9 | 6 | R | E | A | I | O | S | J | I | A | E | | | |
| 3 | 18 | 13 | | 6 | 10 | 2 | 11 | 6 | 10 | 3 | E | S | N | A | T | O | T | I | F | | | | |
| 17 | 3 | 14 | 5 | 10 | | 11 | 19 | 9 | 9 | 12 | 6 | M | I | S | S | P | O | E | T | N | O | | |
| | | | | | | | | | | | | N | I | K | I | M | L | A | M | E | N | | |
| 20 | 9 | 14 | 5 | 19 | 6 | | 2 | 10 | | 3 | 5 | A | N | E | S | T | E | Z | I | S | T | R | A |
| 10 | 19 | 14 | 19 | | 13 | 19 | 20 | 6 | | 10 | 21 | T | A | B | A | R | A | K | A | I | T | | |

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| L | U | I | S | A | K | O | H | A | A | D | | |
| P | O | R | T | A | F | A | T | A | L | E | | |
| E | S | A | D | L | P | R | A | N | I | S | | |
| N | A | T | P | E | L | I | K | A | N | I | H | |
| N | E | L | S | A | B | O | T | I | M | E | T | |
| L | A | K | O | N | I | K | E | T | V | E | T | |
| M | O | N | O | T | O | N | V | E | T | E | M | |
| B | O | L | E | R | O | I | B | E | R | I | K | E |
| S | T | I | M | E | R | R | I | P | A | T | | |
| P | R | E | I | M | E | S | T | I | N | A | A | D |
| I | K | E | A | T | A | A | A | A | A | A | | |
| N | A | T | A | M | L | A | A | P | E | L | | |
| R | O | W | A | N | B | A | R | A | L | L | I | |
| A | B | E | L | P | N | A | T | A | I | A | R | |
| S | O | E | P | I | E | T | T | R | I | O | | |
| A | R | A | T | R | E | T | A | T | O | M | | |
| K | E | I | N | O | T | A | R | E | T | N | A | |
| K | E | H | P | A | M | E | R | I | K | A | N | E |
| E | H | P | A | M | A | D | S | H | | | | |
| K | O | L | O | N | A | K | T | E | C | E | | |
| T | U | N | E | L | E | T | R | E | R | O | S | |
| E | R | A | I | T | K | A | R | E | S | T | I | A |
| T | A | T | S | K | A | R | A | H | E | P | | |
| E | T | J | A | K | A | T | E | T | E | T | I | |

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

Thënie të mençura

- Misteri i jetës nuk eshtë problem që duhet të zgjidhet, por një realitet që duhet të përjetoni. Art Van Der Leeuw
- Lumturia: ekuilibri i matur i dëshirave dhe aftësia për t'i kënaqur ato.
- Shpella që keni frikë të hyni, fsheh thesarin që...
- kërkoni - Joseph Campbell
- Sa më shumë mësoj, aq më pak i sigurt jam...
- për ato që di - John Lennon

